



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Erion Braçe – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015.
3. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar” ratifikuar me ligjin nr.89/2015””.
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

#### **Marrin pjesë:**

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Evis Kushi, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike.

#### **Mungojnë:**

Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Agron Shehaj, Dashamir Shehi, Fatbardha Kadiu dhe Reme Lala.

#### **Të ftuar:**

Dorina Cinari - Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja – Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Enea Karakaçi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Albana Shkurta - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë  
Majlinda Hafizi- Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë  
Tedi Bushaj- Specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë  
Bardhylka Kospiri - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Denada Seferi - Drejtor i programeve të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes  
sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Erion Braçe** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit. Në rendin e ditës së punës së këtij komisioni janë tri çështje:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

2. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015.

3. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar” ratifikuar me ligjin nr.89/2015”.

Fillojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”. Për të prezantuar projektligjin ndodhet në Komisionin e Ekonomisë zonja Bardhylka Kospiri, zëvendësministre e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Relator i komisionit për këtë projektligj është zonja Antoneta Dhima.

Zonja Kospiri, fjalën për të prezantuar projektligjin e keni ju.

**Bardhylka Kospiri** – I nderuar zoti kryetar!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë!

Sot paraqitet për miratim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Ky projektligj ka për qëllim financimin shtesë për projektin e modernizimit të asistencës sociale, nëpërmjet të cilit do të sigurohet mbështetja për të siguruar shtrirjen graduale kombëtare të reformës së aftësisë së kufizuar, si dhe vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e reformave për kriteret e përshtatshmërisë për reformën e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, gjithashtu zhvillimit të një strategjie daljeje dhe një plan-

veprimi për të mbështetur përfituesit e ndihmës ekonomike që dalin nga programi i ndihmës ekonomike.

Miratimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale ka si objektiv përmirësimin e mëtejshëm të barazisë dhe efikasitetit të sistemit të asistencës sociale.

Përmirësimi i barazisë pritet të arrihet nëpërmjet:

1. Zbatimit të kriterëve të reja për përcaktimin e aftësisë së kufizuar, në bazë të modelit social për të paktën gjysmën e popullsisë së vendit;

2. Përmirësimit të aksesit të personave me aftësi në kufizuar në zyrat rajonale të shërbimeve sociale shtetërore, ku edhe merren mendimet përfundimtare për aftësinë e kufizuar.

3. Nëpërmjet harmonizimit të kriterëve të vlerësimit dhe përshtatshmërisë për të dy përfitimet, ato pak kompensime dhe kontribute të aftësisë së kufizuar, dhe vetëpromovimit të përfshirjes sociale dhe ndihmës ekonomike në periudhën e tranzicionit dhe daljen nga programi i asistencës së ndihmës ekonomike me pagesë.

Përmirësimi i efikasitetit pritet të arrihet nëpërmjet:

1. Hartimit dhe përdorimit të raporteve të gjeneruara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të automatizuar për menaxhimin e performancës së programit të asistencës për aftësinë e kufizuar.

2. Përmirësimit të mbikëqyrjes dhe kontrollit të përfitimeve nga programi i asistencës për aftësinë e kufizuar.

Monitorimi i zbatimit të objektivave të projektit dhe reformave të ndërmarra do të bëhet nëpërmjet realizimit të katër indikatorëve, që lidhen me disbursimin. Shuma e kredisë së financimit është 11 000 000 dollarë.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Faleminderit juve!

Po, zonja Dhima.

**Antoneta Dhima** – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale” është nismë e Këshillit të ministrave në zbatim të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si dhe ka ndjekur hapat e përcaktuara në nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e

Shqipërisë”. Projektligji është hartuar në bashkëpunim midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilat do të jenë njëherazi edhe zbatueset e saj.

Marrëveshja e huas, e propozuar nëpërmjet këtij projektligji, është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.206, datë 11. 4. 2018 dhe parashikon shtimin e vlerës së huas në shumën 11 milionë USD. Marrëveshja bazë e huas është ratifikuar me ligjin nr.84/2012, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale””. Sipas kësaj marrëveshjeje Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ka akorduar shumën prej tridhjetë e tetë milionë euro për të ndihmuar financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale, duke mbështetur kështu zbatimin e reformave nga ana e huamarrësit për përmirësimin e barazisë dhe efikasitetit të programeve të tij të ndihmës sociale.

Projekti bazë përbëhet nga 2 pjesë, konkretisht:

Pjesa 1: Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale, përmes mbështetjes së zbatimit të përmirësuar si dhe të programit të ndihmës ekonomike dhe programit të aftësisë së kufizuar nëpërmjet dhënies së financimit për rimbursimin e pagesave që huamarrësi ka bërë nga alokimet e tij buxhetore për programin e ndihmës ekonomike.

Pjesa 2: Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e ndihmës sociale përmes:

Dhënies së asistencës teknike për rishikimin e parametrave të programeve të ndihmës sociale;

Dhënies së asistencës teknike për mbështetjen e zhvillimit të një sistemi të informacionit për menaxhimin;

Dhënies së asistencës teknike për promovimin e transparencës në komunikim, monitorim dhe vlerësim;

Ofrimit të mbështetjes së zbatimit të projektit nëpërmjet financimit të kostove operative dhe dhënies së konsulencës për të përmirësuar ekspertizën teknike.

Marrëveshja bazë është ndryshuar 2 herë, respektivisht nëpërmjet ligjit nr. 117/2016 “Për ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “modernizimi i asistencës sociale”, të ratifikuar me ligjin nr. 84/2012 dhe ligjit nr. 113/2017, “Për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të modernizimit të

asistencës sociale, ratifikuar me ligjin nr. 84/2012. Pala Shqiptare ka kërkuar pranë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim një financim tjetër shtesë në mbështetje të aktiviteteve të reja, të cilat detajohen në Skedulin nr. 1 të kësaj marrëveshjeje dhe konsistojnë kryesisht në sa më poshtë vijon:

**Pjesa 1:** Forcimi i zbatimit dhe performancës së programeve të asistencës sociale, nëpërmjet mbështetjes dhe zbatimit të përmirësuar, si të programit të ndihmës ekonomike, ashtu edhe të programit të aftësisë së kufizuar.

**Pjesa 2:** Asistenca teknike për forcimin e kapacitetit zbatues për programet e asistencës sociale përmes mbështetjes për zbatimin e përmirësimeve në dhënien e pagesave të asistencës sociale nëpërmjet tyre tyre.

Projekti do të jetë pjesë e parashikimeve të programit buxhetor 2019 – 2021 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Afati i fundit për tërheqjen e fondeve të akorduara nëpërmjet kësaj marrëveshjeje huaje është data 30 qershor 2021.

Në përfundim të diskutimeve, duke e vlerësuar projektin e “Modernizimit të asistencës sociale” të një rëndësie të veçantë në kuadër të reformës për zbutjen e varfërisë, rritjes së transparencës, cilësisë së shërbimeve, përdorimit me efektivitet të fondeve buxhetore, si dhe përjashtimit të rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike, ashtu edhe termat e huasë së dhënë nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim si mjaft të favorshme, i propozoj komisionit miratimin e kësaj aktmarrëveshjeje.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Faleminderit, zonja Dhima!

Ka pyetje?

**Jorida Tabaku** - Kam komente, por edhe për procedurë.

**Erion Braçe** – Komente për ligjin?

**Jorida Tabaku** – Në përgjithësi për çështjen. Fjala për procedurë duhet të jepet menjëherë sapo kërkohet.

**Erion Braçe** – Nuk jepet kur jemi në momentin e pyetjeve. Duhet të kishit ardhur më herët. Pyetje bëni sa të doni.

**Edmond Spaho** – Po shikoj të tria marrëveshjet dhe nuk kuptoj cili është ndryshimi midis “denoncimit” dhe “ratifikimit”? Dimë që “denoncim” do të thotë ta hedhësh poshtë, kurse “ratifikim”, e miraton. Në fakt, më duket sikur të tria miratohen.

**Erion Braçe** – Zoti Spaho, jemi te pika e parë e rendin të ditës, projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës

Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

**Edmond Spaho** – Pastaj janë dy të tjera që...

**Erion Braçe** - Janë dy të tjera ...

**Edmond Spaho** – Ato e anulojnë marrëveshjen?

**Erion Braçe** - Kur të diskutojmë për secilën prej tyre mund të adresojmë të gjitha shqetësimet që kemi për to.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atë po them edhe unë.

Po, zoti Haxhinasto.

**Edmond Haxhinasto** – Faleminderit!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Personalisht jam gjithmonë pro akteve që përmirësojnë asistencën dhe në vendin tonë të varfër përpiqen të lehtësojnë sadopak vështirësitë e njerëzve në nevojë.

Si çështje procedurale në trajtimin e këtyre gjërave do të rekomandoja që kur paraqiten akte të tilla, të kemi një pasqyrë pak më të gjerë të sistemit të asistencës sociale. Kjo është një kredi me terma të butë, e cila është për një segment të asistencës. Apo jo? Këtu duhet të dalë më qartë sa shkon nga kjo kredi për çështjet e procedurës, për çështjet e trajtimit, për çështjet e menaxhimit të vetë asistencës dhe sa është përfitimi direkt i qytetarëve. Si ua përmirësojmë ne jetën qytetarëve ose kësaj kategorie që përfiton nga ky grant? Është mirë të vendoset në të gjithë mozaikun e asistencës që ne kemi, me qëllim që të dimë çfarë efektesh kanë akte të tilla, çfarë duhet të përmirësojmë për këtë kategori dhe çfarë duhet të përmirësojmë në tërësi për sistemin e asistencës, sepse 4 vjet më parë u mburrëm se kemi bërë një reformë të thellë të sistemit të asistencës sociale. Pastruam sistemin, hoqëm shumë përfutës të tjera dhe unë mendova që me të vërtetë ne kishim bërë një punë të mirë, cilësore të qëndrueshme. Shqetësimi im është që, pavarësisht kësaj, ne paskemi nevojë për kredi nga BERZH-i për të përmirësuar menaxhimin e të tjera.

A mund të thoni dy fjalë më shumë për ta vendosur këtë në kontekstin e mozaikut të përgjithshëm të asistencës dhe sa përfitojnë njerëzit nga kjo kredi që po marrin nga BBERZH-i?

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Urdhëroni, zonja Kospiri.

**Bardhylka Kospiri** – Faleminderit për komentin dhe pyetjen!

Dua të sqaroj që në fillim që ky projekt i Bankës Botërore ka dy komponentë: i pari lidhet me reformën e ndihmës ekonomike dhe i dyti me reformën e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Në momentin kur ky projekt u dizenjua, në vitin 2010, dhe është ratifikuar kjo marrëveshje në vitin 2012, përqindja e peshës së aftësisë së kufizuar në këtë projekt ka qenë shumë më e ulët krahasuar me ato të reformës së ndihmës ekonomike.

Kështu që, gjatë zhvillimit, zbatimit të projektit, plotësimit të indikatorëve lidhur me reformën e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe gjatë pilotimit, u konstatua që është e nevojshme, sepse nuk ishte parashikuar në masën e duhur dhe në tërësinë e saj nuk përfshinte gjithë problematikën për ta çuar drejt realizimit të qëllimit të vlerësimit të reformës së aftësisë së kufizuar. U gjykua që kishte nevojë për një financim shtesë që kjo reformë të thellohej më tej dhe të realizonte pikërisht ato objektivat e saj.

Objektivat e kësaj reforme janë:

1. Ristrukturimi i modelit ekzistues të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përcaktimin e përfitimeve, duke marrë parasysh ndikimin e ndërveprimit të kushteve shëndetësore. Pra, nuk është thjesht një reformë që fokusohet te vlerësimi mjekësor, por një vlerësim biopsikosocial për aftësinë kufizuar, që merr në konsideratë ndërveprimin e kushteve shëndetësore dhe faktorët kontekstual, që janë faktorët mjedisor, në kryerjen e investimeve themelore ditore të përshtatshme për moshën.

Pra, kjo është shumë e rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara, sepse është një reformë që vendos vëmendjen tek individ. Vlerësimet bëhen rast pas rasti dhe në përputhje jo vetëm thjesht diagnozën që ai sjell me dokumentacion, por me nevojat që ai ka dhe shërbimet e domosdoshme që ai ka në vazhdim.

2. Prezantimi i procesit të përgatitjes së një plani multidisiplinar të mbështetjes individuale për personat me aftësi të kufizuara për të përmbushur nevojat e tyre mjekësore, psikologjike, sociale dhe të zvogëlojë barrierat për përfshirjen sociale.

3. Riorganizimi i administratës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar për të përmirësuar efikasitetin, rritjen e llogaridhënies, duke vendosur kontrole dhe balancime dhe zvogëlimin e mashtrimit.

Në kuadrin e këtyre tri objektiveve, sot reforma është pilotuar në dy zona. Duke qenë se është reformë me ndjeshmëri shumë të lartë, është shumë sensitive dhe normalisht do kujdes në çdo hap që hidhet.

Me financimin shtesë që do të marrim ajo do të shkojë më tej duke u shtrirë në të gjithë Tiranën dhe më tej në tri rajone të vendit, që përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit.

Pra, njerëzit përfitojnë një vlerësim shumë real, ndryshe nga më parë që e kemi pasur thjesht mjekësor dhe të grupuar sipas disa grupimeve, ku mjaftonte të thoshe që përfitoje statusin e tetraplegjikut dhe të gjithë përfitonin njësoj. Jo, kjo nuk ndodh. Sipas nivelit të rëndesës, sipas kushteve mjedisore, të funksionimit të tij e të tjera, ai më tej do të marrë orientimin për mbështetje me shërbime apo sipas përshkallëzimit që do të ketë, do të orientohet drejt punësimit dhe përfitimeve nëse janë fëmijë apo të rritur, sepse tashmë e kemi specifik vlerësimin, veç për fëmijët dhe veç për të rriturit. Fëmijët orientohen drejt një edukimi gjithëpërfshirës, kurse të rriturit, sipas rëndesës, drejt shërbime shëndetësore, sociale, mbështetje për arsim profesional apo për punësim kur janë rastet e lehta.

**Erion Braçe** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zoti Haxhinasto.

**Edmond Haxhinasto** – Ndjesë që e kërкова përsëri fjalën!

Në fakt, i përmbahem konkluzionit të parë, që unë jam pro për çdolloj asistence, por a është i qëndrueshëm sistemi ynë i asistencës sociale? Duhet të mbahet me kredi, qoftë edhe nga BERZH-i, apo e kemi sistem të qëndrueshëm që me buxhetin e shtetit apo me burimet njerëzore ne mund ta vendosim në qëndrueshmëri pa pasur nevojë të marrim kredi të tilla? Edhe nëse nuk është, kur mendojmë ne që do ta vendosim në qëndrueshmëri? 11 milionë ka qenë buxheti i rrugëve në vitin 2016, që nuk është pak, por nëse ne arrijmë ta fusim sistemin e asistencës në qëndrueshmëri dhe me burimet tona njerëzore dhe financiare e përballojmë atë, unë jam dakord.

Pyetja është: E kemi të qëndrueshëm? Nëse jo, kur e bëjmë të qëndrueshëm? Një nga shqetësimet që është shprehur këtu edhe nga institucione të tjera është që ne kemi një hendek në këto sisteme. Edhe në sistemin e pensioneve edhe në sistemin e asistencës kemi një hendek midis asaj që gjenerohet nga sistemi dhe asaj që është kërkesa e sistemit.

**Bardhylka Kospiri** – Faleminderit!

Atëherë, edhe kur është dizenuar dhe ratifikuar si marrëveshje në vitet 2010-2012, qëllimi kryesor ka qenë që të shkojmë drejt konsolidimit të sistemit për ta kthyer atë të qëndrueshëm. Kjo marrëveshje u ndryshua dhe u mor kjo kredi pikërisht për të ngritur infrastrukturën, rritur kapacitetet, për të bërë të mundur që drejt qëndrueshmërisë së sistemit duhet shkuar me këto faza përgatitjeje. Aty jemi. Nuk mund të them një datë të saktë se kur sistemi do të jetë i qëndrueshëm, por ai po bëhet gjithmonë e më i qëndrueshëm në saj të këtyre përpjekjeve që po bëjmë dhe të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, që ka ndikuar, nëpërmjet pilotimeve që kemi bërë në të dyja linjat e marrëveshjes, në ngritjen e kapaciteteve,

sistemeve dixhitale, sistemeve elektronike që kanë rritur transparencën, që kanë thjeshtuar proceset.

Në këto kushte ne po ecim gjithmonë e më shumë drejt qëndrueshmërisë së sistemit.

**Erion Braçe** – Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime?

Urdhëroni, zonja Tabaku.

**Jorida Tabaku** – Kryetar, axhenda e ditës së sotme të Komisionit të Ekonomisë është shembulli dhe rasti më i mirë për të ilustruar atë që opozita ka kohë që e thotë. Jo për faj të këtij komisioni, për faj të qeverisë janë të paaftë të prodhojnë një ligj, një strategji apo të sjellin një gjë të qenësishme në këtë komision.

Zonja zëvendësministre ka ardhur dy herë për këtë marrëveshje për shtyrje dhe shtesë fondesh. Ne i falenderojmë të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë që vendosin të na mbështesin me fonde dhe me projekte në çdo lloj fushe në Shqipëri, por, fatkeqësisht, kjo ministri dhe shumë ministri të tjera janë duke dështuar për të tërhequr fonde të reja.

Marrëveshje të para vitit 2013 vijnë në parlament thjesht për t'u rishikuar, për të shtyrë afatin, për t'u axhustuar kur qeveria ka paaftësi t'i zbatojë ose thjesht për të shtuar edhe fondet, si në këtë rast. Sidoqoftë, opozita mbështet dhe falënderon çdo ndihmë të tillë në cilindo sektor qoftë.

Kryetar, ne duam t'u kthehemi dy diskutimeve, të cilët i patëm dje në këtë komision dhe kemi pothuajse një kohë të gjatë që i përsërisim, i themi dhe ngremë zërin, por, fatkeqësisht, kanë shkuar në vesh të shurdhët.

Diskutuam dje për ligjin “Fusha” të Teatrit dhe për faktin që është antikushtetues dhe në shkelje, të paktën katër ligjeve të tjerë, të dy ligjeve shumë të rëndësishëm, atij për trashëgiminë kulturore dhe atij për vetëqeverisjen e pushtetit vendor. Dje diskutuam edhe faktin që afera e Teatrit është shembulli më i mirë dhe më i thjeshtë i asaj që ne kemi ngritur, që paratë e krimit dhe drogës po depërtojnë në ekonomi.

Në këtë rast ju bëj kërkesë ju, por edhe Guvernatorit, kryetar, që të na vendosë në dispozicion raportin që, dje e kanë publikuar mediat pjesërisht, ne si deputetë të këtij komisioni nuk e kemi. Raporti që ka bërë departamenti i mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, provon katërçipërisht atë që opozita ka theksuar gjatë një viti, pastrimin e parave. Ligji i Teatrit ose afera korruptive e Teatrit është shembulli më i mirë se si kjo ilustron.

I kam kërkuar Guvernatorit, në disa raste edhe ministrit të Financave, të bëj transparencë se me çfarë fondesh po zhvillohet sektori i ndërtimit. Në muaj keni gjetur justifikime të ndryshme. Dje raporti i mbikëqyrjes thoshte e zeza mbi të bardhë: “në disa raste nuk disponohen dokumente që provojnë burimin e fondeve, të cilat mbeten kryesisht në nivel

deklaratash për transaksione të kryera nga klientët me para kesh në llogari individuale dhe tregtare”. Më tej raporti thotë: “Banka e Shqipërisë në inspektimet e saj me fokus rastet e pastrimit të parave ka gjetur transaksione të pajustificuara të kryera në këto banka. Janë gjetur mangësi në plotësimin e të dhënave të klientëve në biznes në sistem, si dhe klasifikimi i klientëve sipas rrezikut, ku konstatohen mangësi në kundërshtim me ligjin e parandalimit të pastrimit të parave”.

Kryetar, qeveria duhet të marrë masa urgjentisht që kjo që po ndodh me pastrimin e parave, kjo që po ndodh me burimet alternative të financimit të biznesit kriminal të ndërtimit të ndalojë njëherë e mirë. Kërkoj që Banka e Shqipërisë të na vendosë në dispozicion këtë raport. Media thotë që është konfidencial, por përderisa disa e kanë marrë, besoj se edhe ne si deputetë mund ta kemi këtë raport. Kërkoj njëkohësisht nga Banka e Shqipërisë të na japë informacion për institucionet financiare jobankare. Sipas raportit, numri i institucioneve financiare jobankare është dyfishuar. Janë institucione të cilat janë jashtë sistemit bankar dhe janë duke u përdorur për pastrim parash. Kërkojmë njëkohësisht informacion për pikat e këmbimit të parave. Sipas të dhënave tona, pikat e këmbimit të parave, të cilat po përdoren njëkohësisht për pastrim parash, janë duke u rritur në mënyrë eksponenciale. Së fundi, kërkojmë informacion edhe nga Ministria e Drejtësisë për kontratat që janë duke u bërë te noterët, informacion që ky raport i departamentit të mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë e përmend. Kontratat e dorëzisë te noterët janë duke angazhuar shuma fondesh të jashtëzakonshme duke i përdorur këto si burim të pastrimit të parave. Raporti i mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë duhet të na vihet menjëherë në dispozicion.

As unë as kolegët e mi nuk ndiejmë fare kënaqësi kur ato që kemi një vit që i themi janë të vërteta. As unë as kolegët e mi nuk ndiejmë fare kënaqësi kur shikojmë se çfarë po ndodh me sektorin e ndërtimit dhe me pastrimin e parave. Mua më duket e ligjshme kërkesa juaj që ky komision të fillojë të angazhohet intensivisht për të marrë informacion për këtë çështje, sepse kjo nuk është më një çështje që i takon Komisionit të Sigurisë, por që duhet ta diskutojmë çdo ditë këtu në Komision, parlament dhe duhet të angazhohet opinioni publik. Unë besoj se njerëzit mund t'i kuptojnë përmasat e kësaj afere vetëm duke e bërë publik informacionin.

Ligji “Fusha” ishte vetëm shembulli se çfarë po ndodh jashtë syve të publikut. Me informacionin që publiku nuk e ka, u materializua ligji që ju kaluat në parlament javën e kaluar.

Bizneset e ndershme, të cilat përditë e më shumë po mbyten nga taksat, e kanë të pamundur të operojnë në këtë ekonomi, e kanë të pamundur që të konkurrojnë në një

ekonomi tregu të lirë kur ligjet e konkurrencës thyhen nga parlamenti, sepse vijnë ligje me emra biznesesh. Bizneset e ndershme sot janë duke mbyllur dyert e tyre. Informacioni që kemi marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit thotë që vetëm në qershor të vitit 2018 kanë kaluar pasiv 1300 biznese, 92% më shumë sesa qershori i vitit 2017. Janar-qershor 2018 janë 7000 biznese ose 49% më shumë se 6-mujori i vitit të kaluar. Nga viti 2014 e këtej kanë kaluar pasiv 68300 biznese. Kjo ka përgjegjës ekonominë krimin që po zhvillohet dhe nuk i lë këta të operojnë të lirë në konkurrencë të lirë, Kryeministrin Rama dhe qeverinë për rritjen e taksave. Hyrja në fuqi në datën 1 prill e TVSH-së 20% i ka dërmuar këto biznese. Taksa e pronës është duke i dërmuar këto biznese. Janë duke u mbyllur masivisht.

Nëse doni bashkëpunim, le të ulemi bashkë dhe të shikojmë se si mund ta ndihmojmë biznesin e vogël, si mund t'i themi stop ekonomisë së krimin, drogës, që sot, fatkeqësisht, është duke mbytur çdo shans që kanë bizneset për të mbijetuar në treg.

Këto janë të dhëna zyrtare të marra nga raportet e qeverisë. Partia Demokratike nuk ka institucione që prodhon të dhëna, nuk ka burime të tjera informacioni përveç atyre që prodhohen nga institucionet zyrtare të qeverisë shqiptare. Jam e sigurt që të dhënat janë akoma edhe më të errëta se këto që unë paraqita sot.

Kryetar, duhet patjetër që Komisioni i Ekonomisë të angazhohet së pari për t'i thënë stop ligjit antikushetues Fusha për Teatrin dhe së dyti t'i themi stop mbylljes së bizneseve duke i ndihmuar ato me një paketë shpëtimi. Unë e di që nuk ka shpresë për integrimin dhe ekonominë me këtë qeveri, por për të ndihmuar bizneset për të mbijetuar ne jemi të gatshëm të japim mendimet tona dhe opinionin tonë. Jam e sigurt që do e hidhni në koshin e plehrave, siç keni hedhur çdo amendament dhe propozim që Partia Demokratike ka bërë.

Faleminderit, kryetar!

**Erion Braçe** – Zonja nënkryetare, raporti të cilit i referoheni nuk është konfidencial, por publik, në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Më vjen keq!

Nëse i referohesh Raportin Vjetor për Mbikëqyrjen të Bankës së Shqipërisë, ai është në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë. Më vjen keq që i bërtisni këtij komisioni për punën që duhet të bëni ju. Pra, të hapni faqet, të lexoni raportin dhe të kërkonit çfarëdolloj gjëje tjetër më pas.

E dyta, për ta kuptuar unë, po kërkon që Guvernatori i Bankës të jetë në një seancë dëgjimore në Komisionin Ekonomisë për çështjen e raportit të mbikëqyrjes apo për ndonjë çështje tjetër? Këtë po më kërkon?

Për të thënë të drejtën, unë e kam të vështirë të bëj punën e postierit, që ju vini dhe flisni dhe unë duhet të mbaj shënim, pastaj të plotësoj kërkesat tuaja. Jo, sipas Rregullores së Kuvendit, për çdo kërkesë që keni, duhet të shkruani dy faqe letër dhe t'ia drejtoni pesonit përgjegjës, që të merrni informacionin që kërkon. Pra, në rast se informacionin e kërkon nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, duhet t'ia adresoni atij. Unë mendoj që edhe kjo procedurë është e tepërt, sepse raporti është i publikuar zyrtarisht në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë dhe me një klikim mund ta merrni.

Edhe një herë tjetër, nëse kërkon një seancë dëgjimore me Guvernatorin e Shqipërisë për raportin e mbikëqyrjes në banka, për të cilin, më lejoni, unë e kam lexuar, i jeni referuar gabimisht nga fillimi deri në fund; i referoheni gabimisht edhe në konkluzione, edhe në citime, edhe në çfarë të doni ju dhe po jua them edhe një herë që i referoheni gabimisht...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju keni dy muaj që thoni të njëjtën gjë dhe ne nuk mërzitemi, ndërsa ju u mërzitët, sepse brenda dy minutave citova 4 herë që e keni gabim. Çfarë është ky muhabet? Ju keni 2 muaj që thoni të njëjtën gjë, sa herë që ju del ndonjë gjë përpara, mbliidhni llaçin, qepën, domaten, pataten, asfaltin dhe çdo gjë tjetër dhe e hidhni përsëri atje, pra thoni të njëjtën gjë për asortimente të ndryshme dhe tani ju vjen keq që them e cituat gabim, zonjë.

Edhe një herë tjetër, raporti i mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë nuk është ai dhe nuk ka ato konkluzione që ju po thoni. Kaq dhe mbaron këtu.

Tani ju lutem shumë më ktheni një përgjigje, nëse doni që guvernatori së bashku me raportin të vijë këtu, unë jam i gatshëm ta bëj kërkesën në emrin tuaj dhe guvernatori të vijë të raportojë për raportin e mbikëqyrjes këtu ose në seancë, ku të doni ju, me dyer të hapura ose të mbyllura, në mënyrë konfidenciale ose jo e të tjera me radhë. Pra, nëse doni, është e thjeshtë fare.

Më falni, zonja Gjylameti.

Të lidhësh raportin e mbikëqyrjes së bankës me leximin tuaj, me ligjin që ju e quani “Fusha” dhe të tjera me radhë, nuk ka sens. Të thuash që me atë ligj po pastrohen para, kur ai ligj krijon thjesht mundësinë për të trajtuar një ofertë që u është paraqitur institucioneve respektive, konkretisht Bashkisë së Tiranës, natyrisht që është e tepërt. Unë vërtet kërkoja që ky komision të ketë në fushën e vet të veprimtarisë edhe çështjen e parandalimit dhe pastrimit të parave, të agjencive respektive dhe të tjera me radhë, por, nëse ju e mendoni pastrimin e parave në këtë formë, atëherë më mirë të mos jetë fare në fushën e përgjegjësisë të këtij komisioni kjo çështje. Më mirë të rrijë atje ku ka ekspertë nga kjo pikëpamje, në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, sesa të vijë këtu. Pra, nëse mendoni që parlamenti ka bërë një ligj që i

krijon mundësi një institucioni të hyjë në negociatë, e cila mund të jetë e suksesshme, mund të dështojë dhe mund të sjellë ose jo një kontratë dhe juve këtë ta quani pastrim parash, kjo është një histori tjetër dhe unë nuk merrem dot me këtë gjë, po jua them që tani. Unë këtë gjë nuk e bëj dot, sepse me aq sa kam lexuar unë për pastrimin e parave, nuk më rezulton që ky ekuacion të ketë si produkt final pastrimin e parave.

Faleminderit!

**Jorida Tabaku** – Zoti kryetar, në fakt, ju dini më shumë se kaq dhe jam e sigurt që dini më shumë se të më keqcitoni mua. Kur Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ishte këtu, unë i kam bërë pyetje respektive, duke përfshirë edhe raportin e mbikëqyrjes që është publik, për të cilat ju nuk e latë guvernatorin të kthente përgjigje. Prandaj ju besoj se e dini shumë mirë që unë di ta bëj diferencën mes raportit që është publik, për cilin bëra pyetje konkrete, ku përgjigjet nuk u lejuan, dhe atij raporti që është konfidencial, që përmend disa aspekte për të cilat ngrita shqetësimin. Pra, unë e bëj diferencën dhe ju e bëni diferencën.

Së dyti, më vjen mirë që për herë të parë ju u prononcuat këtu për “ligjin Fusha” dhe që disa ekspertë në qeverisje paskan thënë që nuk pastrohen kështu paratë. Në fakt, duhet t’ju besojmë ju, sepse nuk kemi ndonjë ekspert për pastrimin e parave, ndoshta qeveria ka ngritur një sistem tjetër për pastrimin e parave dhe besoj se e keni të sigurt burimin e informacionit nga qeveria. Por një kompani me ato bilance si “Fusha”, një kompani me aq kapital sa “Fusha”, një kompani që i falen 7500 metra truall publik, bëri një ofertë të dinte që teatri do të prishej. Një nga 10 pronarët bën një ofertë të pakërkuar, ku parlamenti ngrihet e kthen në ligj dhe e miraton.

Po jua them që kontrata është e gatshme në Bashkinë e Tiranës, sepse nuk ka kohë, nuk mund ta negociojnë kontratën për 30 ditë, ajo është e gatshme dhe do ta shikoni kur kontrata do të dalë sapo të miratohet ligji dhe të zbardhet në Fletoren Zyrtare.

Sipas mendimit tonë, kjo është një mënyrë sesi pastrohen paratë, këtë na e përforcon edhe Departamenti Amerikan i Shtetit. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit thotë: hotelieri – turizmi dhe ndërtimi janë dy sektor ku po pastrohen para, këtë jua kam theksuar dhe jua kam treguar disa herë, por ju keni refuzuar që ta dëgjoni. Ne këto burime informacioni kemi. Sistem për pastrimin e parave ka ngritur qeveria dhe ne nuk dimë se si zhvillohet, por thjesht ofrojmë të dhëna që ndihmojnë për të sqaruar atë çfarë po ndodh me ekonominë dhe me sektorin bankar.

Kërkesa që bëra për më shumë informacion nga Banka e Shqipërisë ose nga çdo institucion tjetër që ka informacion në fushën e pastrimit të parave dhe vendosjen në dispozicion të deputeteve, besoj se është e ligjshme. Që të gjithë mund të firmosim certifikatë

sigurie nëse është e nevojshme dhe mund të marrim informacione. Por që ekziston një raport konfidencial dhe që ka të dhëna për këto që unë përmenda, përveç raportit publik që ka përgatitur Banka e Shqipërisë, sigurisht që ka.

**Erion Braçe** – Zonja Tabaku, unë ju sfidoj të më tregoni raportin konfidencial.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Atëherë janë dy gjëra, a është raporti konfidencial i qeverisë apo i Bankës së Shqipërisë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në raportin konfidencial?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E para, duhet të saktësosh se i kujt është raporti, me qëllim të përmbushni sfidën. Unë ju sfidoj edhe një herë tjetër, nëse ka raport tjetër veçmas apo i ndarë nga raporti i mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë, atëherë keni plotësisht të drejtë, por ju lutem shumë të ma tregoni këtë raport.

**Jorida Tabaku** – Sa herë që më keni sfiduar jua kam dhënë me prova dhe me fakte, nuk kam folur ndonjëherë pa ndonjë dokument zyrtar në këtë komision, do ta siguroj e do t’jua paraqes.

**Erjon Braçe** – E kam parë që më keni sfiduar me prova dhe me fakte.

E dyta, që dua t’ju them, a kërkon që Guvernatori i Bankës së Shqipërisë të vijë këtu, apo jo?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Guvernatori do të vijë me prova dhe me fakte. U bënë dy.

E treta, nuk ka ndodhur në këtë komision që unë të kem ndaluar Guvernatorin e Shqipërisë t’u përgjigjet pyetjeve. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka qenë këtu dhe ju nuk keni qenë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Tabaku, Guvernatori i Bankës Shqipërisë i përgjigjet pyetjes së personit që është prezent, në momentin kur zgjedh të mos jesh fare në komision, nuk ka se si të të përgjigjet Guvernatori. Unë nuk besoj se ju i bëni pyetjet virtualisht dhe Guvernatori duhet t’u përgjigjet përmes medias, për sa kohë që komisioni të ka krijuar mundësinë që të jesh përballë me Guvernatorin, ta pyesësh që të marrësh përgjigje. Për sa kohë që nuk je përballë me Guvernatorin nuk mund të marrësh përgjigje, është fare e thjeshtë.

E fundi, ju lutem shumë, meqenëse flisni me fakte dhe me prova, ju lutem saktësoni numrat. Dje dëgjova zonjën Vokshi që fliste për 4750 metra katrorë pronë publike të Teatrit,

që po i vihet në dispozicion tjetrit dhe tjetrit, ndërsa ju thoni 8000 metra katrorë. Ju lutem saktësojeni, se sa është. A është 4750 metra katrorë, sa thoshte dje zonja Vokshi, që është eksperte në lëmin e imobilitareve, apo është 8000 metra katrorë sa thoni ju?

**Jorida Tabaku** – Së pari, komente për kolegët që nuk janë këtu, nuk ka kuptim të bëhen. Po të citoj letrën e hipotekës që zonja Vokshi i referohej, 8600 metra katrorë është prona publike e Teatrit, 5522 metra katrorë është sipërfaqja totale e projektit, 5522 metra katrorë është prona e teatrit, 2100 metra katrorë është prona që ka bashkia dhe ka një sërë institucionesh të tjera duke përfshirë edhe KLSH-në që ka truall publik dhe shkojnë në totalin që përmendi zonja Vokshi. Kur të jetë ajo këtu, referojuni asaj. Komente për njerëz që nuk janë këtu është mirë të mos bëjmë.

**Erion Braçe** – Pra, Teatri ishte 5200 metra katrorë?

**Jorida Tabaku** –Kërko zyrtarisht informacion siç ka kërkuar zonja Vokshi dhe do ta marrësh.

**Erjon Braçe** – Faleminderit!

Administratori kërkesën e zonjës Tabaku për seancën dëgjimore me Guvernatorin.

Fjalën e ka zonja Gjylameti.

**Blerina Gjylameti** – Zoti kryetar, nëse ju me nënkryetaren keni nevojë të keni dialog me kamera, mendoj që i keni mundësitë t’i thërrisni kamerat kur të jeni vetëm, sepse nuk besoj se ky komision është vetëm për dialogun tuaj. Keni mundësi t’i thërrisni dhe të bëni një seancë vetëm ju të dy dhe të vazhdoni këtë histori. Kjo ishte e para.

E dyta, mendoj se zonja Bardhylka ka mbaruar punë, për sa kohë ne po flasim për çdo gjë, por vetëm për projektligjin jo. Që do të thotë: ne flasim për asistencën, ndërkohë flasim për pastrimin e parave; pastaj kalojmë tek ekspertiza, kemi apo nuk kemi ekspertë; kemi informacion, por është konfidencial; e ka çdo kush, por nuk e kemi ne; tani e dimë që e kanë, po nuk e paskemi, prandaj ndajeni mendjen dhe bini dakord se çfarë doni dhe çfarë kërkon.

E treta, mua më duket e papranueshme që çdo ditë të degjenerojë diskutimi në këtë komision. Nëse kolegët e opozitës donin informacion për Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe për raportimin që pati KLSH-ja në Kuvend, duhet të ishin prezent, sepse seanca ishte e gjatë dhe mundësitë ishin të mëdha që të merrnin të gjithë informacionin që donin dhe jo të zgjidhnin të mos ishin.

Vijmë sot në komision dhe thonë: nuk ishim prezentë, a thua se i përjashtoi kush nga komisioni. Komisioni ishte dje dhe lexuam edhe rezolutën, kolegët e tjerë të opozitës bënë edhe sugjerimet e tjera që të përfshiheshin në rezolutë. Meqenëse i keni këto shqetësime, të zgjidhni të ishit prezent dje dhe jo të bëjmë të njëjtin teatër që bëhet çdo ditë, ku vijmë dhe

bëjmë një deklaratë, bllokojmë punën e komisionit, largohemi dhe pastaj kthehemi të nesërmen dhe themi që ne dje nuk ishim prezentë.

Askush nuk jua heq të drejtën e fjalës, por ama askush nuk më heq mua të drejtën që të kërkoj që të ketë normalitet në këtë komision. Për sa kohë kemi një rend dite, ju lutem përmbahuni; nëse nuk i përmbaheni, atëherë vazhdoni dhe bëni deklaratat së bashku ju të dy në një vend tjetër dhe jo në këtë mbledhje.

Faleminderit!

**Erion Braçe** – Faleminderit, zonja Gjylameti, që morët fjalën që unë të mos bëj dialog.

Fjalën e ka zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Në fakt, për komisionin tonë sot është një ditë e trishtueshme, sepse na janë paraqitur dy marrëveshje për t'i anuluar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Meqenëse doni të flasim për rendin e ditës, por ju vetëm dini të qeshni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Janë dy marrëveshje, njëra për financimin e biznesit të vogël dhe të mesëm në zonat urbane dhe rurale, prej 5 milionë eurosh, e cila ka më shumë se 5 vjet që...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të flas edhe për zonjën, sepse do të vijmë përsëri këtu për ta anuluar edhe projektligjin e sotëm.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Do të vijmë një ditë tjetër që ta anulojmë edhe këtë, prandaj duroni pak.

Ky është një shqetësim i madh, që një marrëveshje për financimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, pavarësisht se ju qeshni, nuk është përdorur fare dhe nuk është bërë asnjë veprim. E keni të trashëguar nga qeverisja jonë, po bëni 5 vjet në qeverisje dhe sot na sillni marrëveshjen për ta anuluar, në një kohë kur më shumë se çdo sektor tjetër ka shumë nevojë për financimin e biznesit të vogël dhe të mesëm. Këtu nuk ka punë dhe njerëzit po ikin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E di moj, zonjë, se çfarë është, nuk është nevoja të ma thuash ti, por, meqë kërkoje që të flitej për rendin e ditës, ke pak respekt dhe dëgjo, se për rendin e ditës po flas.

**Erion Braçe** – Zonja Gjylameti, mos bëni dialog me zotin Spaho.

**Edmond Spaho** – Po anuloni një marrëveshje, ky duhet të jetë shqetësimi për ty, që t'i drejtohesh kryetarit dhe jo ato që the deri tani. Është shqetësim që po anuloni një marrëveshje me Republikën Federale Gjermane, me një shumë prej 5 milionë eurosh, së

bashku me marrëveshjen për eficiencën e energjisë, 12 milionë euro, do të anulohen, sepse qeveria shqiptare nuk ka bërë asnjë veprim. Kjo duhet të të shqetësojë ty dhe ne bashkë, sepse fondet që na jepen për shkak të paaftësisë së qeverisë dhe mungesës së kontrollit edhe nga ju si deputetë, nuk arrini t'i shfrytëzoni për qëllimin për të cilin janë miratuar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Lërimi arsyet, ato kanë me vite që nuk janë përdorur dhe më tregoni arsye. Arsye për të anuluar gjithmonë gjenden, por fakti që nuk janë përdorur, do të thotë që duhen anuluar. Marrëveshja e parë është që në vitin 2010 dhe, e dyta, është që në vitin 2015, pra me vite të tëra që nuk është bërë asnjë veprim, sigurisht që do të anulohen, sepse edhe ata kanë plane financiare kur i kanë parashikuar për t'ia dhënë një vendi dhe, nëse ikën viti financiar, nuk ka më para që të japin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po na thoni çudira, po e quani sukses të madh edhe kur anulojmë marrëveshje, edhe duhet të lavdërojmë qeverinë dhe të brohorasim, sepse po anulojmë 17 milionë euro kredi të dhënë nga Republika Federale e Gjermanisë. Mos flisni kështu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në fakt, ju nuk ju bën çudi pse janë 5 milionë euro...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E ke në rendin e ditës, gjithashtu shpreh dyshimin që marrëveshja që po diskutojmë ndoshta do të ketë fatin e këtyre dy të tjerave dhe do të vijmë një ditë me propozimin e qeverisë që ta anulojmë, sepse nuk kemi "gjoja" nevojë për fonde për asistencën sociale, as për modernizmin dhe as për fuqinë njerëzore. Përse po e përjashtoni si mundësi, për sa kohë dy marrëveshjet e tjera po i anuloni edhe këtë që sot po e miratojmë, mbas një ose dy vjetësh mund të vini dhe të thoni do ta anulojmë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kështu na thatë edhe për dy të parat dhe i anuluat, prandaj mos jepni kaq shumë garanci, sepse me këtë qeveri vetëm garanci nuk ka. Por ndoshta 5 milionë dhe 12 milion euro nuk janë ndonjë gjë për ju, janë si një bakshish që paguhet në restorant. Po të fusësh në një makinë 3 milionë e gjysmë euro kontrabandë për t'i larë këtu, sigurisht që 5 milionë që jep Gjermania për biznesin e vogël dhe të mesëm nuk ju hyjnë në sy. Ju duket çudi, por, kur hyjnë 180 milionë euro me 613 kg kokainë, përse duhet të rrimë dhe të merremi me 5 milionë eurot e Gjermanisë, që vetëm letra dhe diskutime kush e di se sa janë bërë. Nuk ka eficiencë, është më kollaj me sjellë 600 kg kokainë dhe zgjidhet. Pse të merremi ne me 17 milionë euro

me vite të tëra, lidhim një kontratë me 205 milionë euro fitim tek Teatri, sepse vetëm fitimi është 205 milionë euro.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ashtu është.

**Erion Braçe** – Zoti Bejtja, ju lutem, mos ndërhyri fare.

**Edmond Spaho** – Më mirë të bësh biznes me pronën e shtetit dhe t’ia japësh “Fushës” për të fituar 205 milionë euro, sepse ai vetëm letrat dhe emrin ka atje, janë të tjerë ata që rrinë mbrapa, ai do të dalë, por nuk del dot, se sa të merresh me ato marrëveshje.

Çështja e fundit që dua të ngre, zoti kryetar, megjithëse nuk do të bini dakord, ne kemi votuar një ligj për kontratën e teatrit, e cila çuditërisht nuk u shqyrtua në Komisionin e Ekonomisë, por që duhej të shqyrtohej edhe këtu, i cili është votuar në mënyrë të parregullt. Ne e ngritëm si shqetësimin javën e kaluar, pavarësisht se mblodhët Komisionin e Rregullores dhe të Procedurave, atje u vërtetua që votimi ishte i parregullt, pavarësisht hileve që përpiqeni të bëni që e ka fajin maxhoranca apo opozita, kushdo që e ka fajin, votimi ka qenë i parregullt dhe ne duhet të vazhdojmë të kërkojmë rivotimin e ligjit, sepse është bërë në mënyrë antikushtetuese, e para.

Së dyti, është turp e faqe e zezë që në Kuvendin e Shqipërisë, në seancën plenare të vidhen votat sheshit nga maxhoranca. Juve nuk u bën përshtypje, sepse keni vjedhur me qindra dhe mijëra vota në zgjedhje, keni vjedhur pushtetin, ndaj sot keni një mandat të dytë të vjedhur. Kështu që nuk ju bën përshtypje kur merrni një votë dhe vini në favor të ligjit për Teatrin, në një kohë që nuk ju duhet. Prandaj, edhe njëherë do t’ju bëja thirrje që, në cilësinë e ligjvënësve, por edhe si grup deputetësh, që jemi këtu në Komisionin e Ekonomisë, nga të dyja krahët, të insistojmë që të vendosim disa rregulla formale dhe ligji të rivotohet, pasi nuk është dinjitoze, nuk është kushtetuese që ai ligj të quhet i miratuar për mënyrën se si u votua.

**Erion Braçe** – Zoti Spaho, unë ju respektoj shumë për të gjithë kontributin tuaj, për qëndrimet e mbajtura kohë pas kohe, por edhe për përgjigjet e ndryshme që keni dhënë në këtë komision, qoftë nga pikëpamja politike, qoftë edhe nga pikëpamja profesionale. Unë do të pranoja me kënaqësi çfarëdolloj politike që vjen nga opozita, nga ju personalisht apo edhe nga kolegët e tjerë, por këto që thatë, më vjen keq, nuk qëndrojnë. Po të lexoni t’i dyja relacionet e projektligjeve, për të cilat ju folët dhe akuzuat qeverinë, akuzuat maxhorancën, akuzuat deputetët e këtij komisioni dhe iu drejtuat me një ton aspak etik zonjës që është në komision, do të kuptoni se nuk kanë lidhje fare me këto dy marrëveshje. Kjo projekt marrëveshje ishte parashikuar të zbatohet nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe do të monitorohej nga një banke gjermane, që quhet KfW. Gjatë periudhës shtator të vitit 2015-

2016 KfW-ja ka kontaktuar periodikisht bankat e nivelit të dytë për të mundësuar bërjen efektive të linjës së kredisë, por pa sukses, pasi në të gjitha takimet është evidentuar fakti që bankat nuk kanë mangësi likuiditeti. Ata propozuan nevojën e krijimit të një fondi të veçantë për kreditimin e SME-ve. Ndërkohë, në nenin 1 të marrëveshjes qeveritare, të ratifikuar me ligjin nr. 86/2015, përcaktohet se projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të reja.

Të gjitha çfarë thatë për qeverinë e Republikës së Shqipërisë, për këtë maxhorancë, për dështimin, për mossuksesin dhe për çfarëdolloj gjëje tjetër, nuk kanë lidhje fare me këtë marrëveshje. Mund të kenë lidhje me “ligjin Fusha”, pa asnjë problem, sepse kështu e gjykoni ju, por me këtë marrëveshje nuk kanë lidhje. Për sa kohë që në një marrëveshje përcaktohet se linja e kredisë prej 5 milionë eurosh do të trajtohet, do të disbursohet nëpërmjet bankave të nivelit të dytë, do të monitorohet nga vetë KfW-ja në raport të drejtpërdrejtë me këto banka dhe kur ky raport i drejtpërdrejtë, i vendosur nëpërmjet KfW-së dhe bankave të nivelit të dytë, dështon, si dhe kur përtej gjithë kësaj historie vetë qeveria Federale e Gjermanisë propozon që kjo marrëveshje të bjerë për këtë arsye dhe të zëvendësohet me një marrëveshje të re, atëherë arsyet janë këto që thonë gjermanët, jo këto që thoni ju në mënyrë partizane. Këtu mbaron kjo histori.

E njëjta arsye është edhe për marrëveshjen e dytë. Është e shkruar qartë në relacion, paragraf më paragraf, sepse thuhet e njëjtë gjë: “Bankat nuk kishin nevojë për likuiditet nga kjo marrëveshje për të financuar këto projekte”. Për këtë arsye qeveria Federale e Gjermanisë ka propozuar një marrëveshje të re për të mos ia mohuar Shqipërisë këto para, por për t’i adresuar në sektorë që janë më jetikë dhe që kanë nevojë për likuiditet. Pra, nuk ka asgjë nga ato që thatë ju deri tani.

Së dyti, mua më vjen keq, zoti Spaho, sepse, me gjithë përvojën që ju keni në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, që t’i ktheheni asaj çështjeje të poshtër të votimit të “ligjit Fusha” siç e quani ju. Është e turpshme dhe e neveritshme ajo që kanë bërë disa kolegë tanët në sallën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. E kanë bërë për t’u tallur, e kanë bërë me paramendim apo për të dalë tek ai aksioni banal politik, unë nuk e di, por është e turpshme! Është e provuar me video dhe me dokumente zyrtare të Kuvendit, që zoti Bitri nuk ka votuar kur është bërë testi për prezencën, por ka votuar zoti Vangjel Tavo. Në sistem figuron karta, që kolegët tanë kanë vendosur në folenë e parashikuar për vendin e zotit Bitri (ja ku është e shkruar këtu), por zoti Bitri nuk figuron votues me emër dhe me mbiemër në rastin e “ligjit Fusha”, siç e quani ju, por rezulton të ketë votuar zoti Vangjel Tavo. Pra, zoti Bitri nuk figuron fare në tabelën elektronike të votimit që printohet menjëherë pas votimit. Po

e përsëris, dhe ju keni shumë të drejtë, sepse është e turpshme dhe këto janë turpe që konsumohen në Kuvendin e Republikën e Shqipërisë. Në qoftë se ka një gjë me të cilën unë nuk jam dakord me Sekretariatit e Votimit është pikërisht kjo që duheshin paditur ata që e bënë këtë gjë, pa asnjë lloj diskutimi. Pra, ata që e bënë këtë gjë duheshin kallëzuar, sepse është turp të heqësh apo vendosësh kartën e tjetrit dhe më pas të dalësh dhe të thuash: “Shiko si vodhi ky”, ndërkohë që ai nuk figuron askund votues. Për pjesëmarrjen në votim nuk figuron, nuk figuron as në votimin e fundit fare. Urdhëroni, shikojeni, sepse nuk figuron në asnjë prej votimeve! Këtë e provon sistemi elektronik, jo unë, jo dëshira ime për t’i ikur kësaj çështjeje, por e provon sistemi elektronik i Kuvendit. Siç e thashë, unë bashkohem me ju në një pikë, që këto janë turpe dhe këta që i bëjnë këto turpe nuk duhet të hyjnë më në Kuvendin e Shqipërisë. Në këtë pikë jam dakord me ju pa asnjë diskutim!

**Edmond Spaho** – Zoti kryetar, ju u përpoqët që të më jepnit shpjegime, por janë të sforcuara dhe i bëjnë bisht çështjes. Lidhur me rastin e marrëveshjes për financimin e sektorit bankar, a nuk ju shqetëson fakti se qeveria ka kërkuar financim nga Republika Federale e Gjermanisë vetëm për një fushë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Lëreni radhën tani! Po më tregoni radhën ju mua! Unë po them thelbin, kursi ti më thua prit! Në radhë, sipas rendit të ditës, është kjo, kurse ju e keni filluar nga e katërta.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk është ky thelbi! Thelbi është: pse qeveria ka kërkuar financim nga Gjermania për një fushë që nuk ka nevojë dhe ka humbur 3 vjet, nga viti 2015 deri në vitin 2018.

Së dyti...

**Erion Braçe** - Zoti Spaho, më falni që po ju ndërpres! Unë nuk të lejoj të fyesh, sepse këto para i ka kërkuar qeveria juaj në vitin 2010. Kjo është e turpshme!

**Edmond Spaho** - Marrëveshja është e vitit 2015!

**Erion Braçe** - Është e turpshme të abuzosh me faktet.

**Edmond Spaho** - Më dëgjoni! Marrëveshja për financimin e biznesit afatmesëm është e vitit 2010 dhe ka 8 vjet që nuk është vënë në zbatim, dhe ju keni 5 vjet që keni ardhur në qeveri.

**Erion Braçe** - Lexojeni këtu, sepse ta thotë banka, zotëri!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Edmond Spaho** - Mos më ndërprisni!

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Jorida Tabaku** – Kryetar, a ka mundësi të marr fjalën?

**Edmond Spaho** – Ato para duhet të ishin përdorur në një fushë tjetër, pra ishin kërkuar për tjetër gjë. Nëse më thua se nuk kishit nevojë, atëherë pse i kërkuat?! Kanë kaluar 5 vjet që kur keni ardhur në qeverisje, atëherë pse nuk është shfrytëzuar ende fondi?!

Së dyti, e njëjta logjikë është edhe për fondin e eficiencës së energjisë. Pse është kërkuar ai fond kur nuk përdoret? Apo po e anuloni marrëveshjen? Pse kanë humbur 3 vjet kohë? Këto janë pyetje që ju duhet t'ia bëni vetes.

Së treti, sa për votimin, unë nuk marr përsipër që të jap përgjigje në emër të të tjerëve, sepse ata ta dhanë përgjigjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Tregoni pak më shumë respekt! Ata ta dhanë përgjigjen me argumente që nuk janë ashtu siç i pretendoni ju, por janë krejt ndryshe. Po ta them në marrëdhënie personale, sepse më duket shumë e çuditshme që për aq sa e njoh unë zotin Panariti, siç ju pretendoni, nuk merret me të tilla punë. Është e njëjta situatë si dikur kur thatë se në makinën e Aldo Bumçit gjetët një arsenal me armë. Zoti Panariti, nuk është nga ata persona, është nga më të nderuarit në Kuvend dhe nuk është nga ata që bën të tilla punë, që të heqë kartën, ta vendosë përsëri dhe të falsifikojë votimin. Ndaj, tregohuni realistë për ato që keni bërë dhe duhet të anuloni votimin. Ka pak rëndësi se kush e ka bërë, sepse Rregullorja e përcakton qartë se kur votohet në emër të tjetrit, votimi është i parregullt dhe anulohet, ndaj ju duhet ta anuloni.

**Erion Braçe** - Zoti Spaho, mbaruat?

**Edmond Spaho** – Po, mbarova!

**Erion Braçe** - Atëherë, kam përshtypjen se këto gjëra do t'i sqarojë zonja Kushi, si relatore e komisionit, sepse të ftuarit nuk kanë lidhje fare me ato që ju pretendoni. Në lidhje me votimin, ajo që thotë në mënyrë të qartë LSI-ja apo zoti Panariti janë gënjeshtër.

Zoti Bitri, kur ka hyrë në sallën e Kuvendit, nuk ka votuar me kartën e tij, zero. Ja ku është sistemi elektronik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Zonja Tabaku, unë e kuptoj që ju jeni e zënë, por unë jam i detyruar që të dëgjoj edhe zotin Panariti, edhe LSI-në. Ata thanë se vërtet e vendosën kartën e zotit Tavo në vendin e zotit Bitri, por kur zoti Bitri hyri në sallë, pretendon LSI-ja, e hoqi kartën e zotit Tavo dhe vendosi kartën e vet dhe kartën e zotit Tavo. Në fakt, nga sistemi elektronik i votimit rezulton se ka votuar vetëm zoti Tavo, ndërkohë që rezulton se zoti Bitri nuk ka votuar. Unë mund të pranoj argumentin e kujt do, por jo gënjeshtrenë e kujt do. Kam respekt për personat, por i besoj elektronikës. Ja ku e keni!

Atëherë, zonja Kospiri duhet të largohet në një komision tjetër, kështu që nëse ndonjëri ka ndonjë gjë lidhur me këtë marrëveshje ,mund të flasë.

Po, urdhëroni.

**Endri Hasa** – Çështjet duhet të diskutohen në themel me të ftuarit dhe jo thjesht të ikin sepse janë në komisione të tjera. Ti vetë e ke caktuar rendin e ditës, zoti Braçe, ndaj përmbaju.

Nga një anë anulohen këtu dy marrëveshje, nga ana tjetër, merret një kredi për modernizimin e asistencës sociale për vazhdimin e projektit. Mua më bëhet qejfi që më në fund juve ju kujtua dhe pranuat këtu se quhet “ligji Fusha”. Ti, nga njëra anë, thua se do të modernizoni asistencën sociale dhe nga ana tjetër praktikisht fal 200 milionë euro, ose më mirë i vidhni 200 milionë euro, ose 4 mijë euro për çdo 5 mijë familje që janë me ndihmë ekonomike. Ju bëni pallavra këtu dhe thoni se do të merrni 11 milionë euro për të bërë drejtësi. Çfarë drejtësie ka asistencë sociale? Cila është kjo drejtësi? Drejtësia që po i shtohen të shtohet ndihma sociale në një bashki të caktuar dhe i hiqen një bashkie tjetër? Ajo drejtësi që e manipulon sistemin dhe që fut duart në sistem? Çfarë drejtësie doni të bëni ju këtu? Çfarë drejtësie doni të bëni kur edhe mediet ia hoqët sinjalin, jo këtu direkt, por atyre që janë përjashta? Aq frikë keni nga fjala, sa bëni çmos që të mos transmetohet, sepse para 10 minutave, poshtë Kryesisë së Kuvendit, janë lëvizur të gjitha makinat e medieve nga policia. Kjo nuk ka ndodhur ndonjëherë, që poshtë Kryesisë së Kuvendit të spostohen makinat e medieve dhe të gjobiten mediet nga policia. Si nuk ju vjen turp! Çfarë doni të arrini me këtë? Ju doni vetëm të vidhni me ligj.

“Kemi harruar Vilmën” - thotë Evisi! Ne nuk e kemi harruar Vilmën, por nuk është vetëm Vilma, është edhe “Fusha” dhe janë 200 oligarkë të tjerë dhe nuk është asnjëri më i mirë. A e dini se çfarë kanë një gjë të përbashkët të gjithë këta? Kanë qeverisjen tuaj, kanë Edi Ramën. Kjo është e përbashkëta, sepse ai kryehajduti dhe kjo që po bëni ju sot është vjedhje. Ju bëni sikur do të ndihmoni të varfrit dhe vidhni këtë vend, vidhni pronën publike të Teatrit dhe flisni këtu për ndërrime kartash. Kush i ndërron kartat? Taulant Ballën kam parë që ndërron kartat për procesin antikushtetues të zgjedhjes së Prokurores së Përgjithshme?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Pse thoni: “Pikë e zezë!”? “Nuk më pëlqen, nuk ka likuiditet” - the për kredinë tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Duhet të më dëgjosh, sepse kam të drejtën time të flas!

**Erion Braçe** - Më falni, sepse po të dëgjojmë me respekt ty, por mos na trego turpin ti tani, e të tjera me radhë!

**Endri Hasa** - Po, do ta tregoj edhe turpin!

**Erion Braçe** - Ti nuk duhet të flasësh fare në këtë komision, sepse ti nuk ke lidhje me këtë komision.

**Endri Hasa** - Si nuk paskam lidhje me këtë komision?!

**Erion Braçe** - Jo, nuk ke lidhje fare.

**Endri Hasa** - Unë kam të drejtën time kushtetuese.

**Erion Braçe** - Së pari, ti nuk ke lidhje fare dhe të gjitha çfarë po thua nuk kanë lidhje fare me rendin e ditës së kësaj mbledhjeje.

Së dyti, në qoftë se doni të flisni për ligjin, atëherë flisni, por nëse nuk doni të flisni për ligjin, kalojmë në votim dhe e mbyllim këtë histori!

**Endri Hasa** - Më lini të flas!

**Erion Braçe** - Edhe njëherë: në qoftë se nuk doni të flisni për ligjin, atëherë e mbyllim.

**Endri Hasa** - Unë për ligjin po flas! Se si i bëj unë argumentet, ato janë të miat, nuk janë tuajat.

**Jorida Tabaku** – Kam një çështje procedurale!

Së pari, çdo deputet i Kuvendit të Shqipërisë ka të drejtë të flasë, zoti kryetar!

**Erion Braçe** - Të flasë, por jo të fyejë!

**Jorida Tabaku** – Ne nuk dëgjuam të fyente njeri!

**Erion Braçe** - Zonja Tabaku, nëse këta kolegët që janë këtu kanë durimin maksimal që të dëgjojnë lloj-lloj dënglash këtu, kjo është tjetër histori. Këtu nuk mund të fyhet askush. Kaq, dhe mbaron këtu!

**Jorida Tabaku** – Konkretisht për çfarë?

**Erion Braçe** - Unë nuk jam polic dhe asnjë prej këtyre këtu nuk është polic që të lirojë trotuarin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Erion Braçe** - Këtu nuk bën asnjëri policin dhe të ruajë trotuaret. Në qoftë se ke hallin e trotuarit, dil atje poshtë dhe ruaje trotuarin dhe dilu për zot atyre atje poshtë.

**Jorida Tabaku** – Më lini ta përfundoj propozimin që kisha, zoti kryetar!

**Erion Braçe** – Së dyti, në qoftë se keni akuza të drejtpërdrejtë, duke filluar nga unë deri tek i fundit, bujrum thuajeni! Shprehjen: “Ju këtu jeni hajdutë”, harrojeni se do ta përdorni më! Shkoni dhe përdoreni me ata që vjedhin, jo këtu.

Së fundi, në qoftë se keni ndonjë gjë për ligjin, atëherë flisni! Në qoftë se nuk keni asgjë për ligjin, e mbyllim këtu dhe kalojmë në votim.

**Jorida Tabaku** – Kam një propozim procedural!

A mund ta votojmë ligjin që të largohet zëvendësministrja dhe zoti Hasa të vazhdojë diskutimin që kishte.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Klevis Balliu** - Më jepni vetëm një minutë, sepse kam për të thënë diçka! Në Pogradec janë rreth 1700 familje me ndihmë ekonomike...

**Erion Braçe** – Pyetje nuk ka, por në qoftë se keni interes për këtë çështje, mund të bëni një interpelancë, ose t'i thërrasim të ftuarit një herë tjetër në komision, por jo sot.

**Klevis Balliu** - Dakord! Atëherë, le kalojmë në votim.

**Erion Braçe** – Atëherë, hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonja Kospiri, ju kërkojmë shumë ndjesë që ju mbajtëm kaq gjatë, në mënyrë të panevojshme, ndaj mund të largoheni!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Ekonominë dhe Financat*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Erion Braçe – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar” ratifikuar me ligjin nr. 89/2015””.

#### **Marrin pjesë:**

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Evis Kushi, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike.

#### **Mungojnë:**

Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Agron Shehaj, Dashamir Shehi, Fatbardha Kadiu dhe Reme Lala.

#### **Të ftuar:**

Dorina Çinari- Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja - Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Albana Shkurta - zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi – drejtore në Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Erion Braçe** – Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar” ratifikuar me ligjin nr. 89/2015””.

Për ta prezantuar këtë projektligj të pranishëm në komision janë zëvendësministriat respektivë të Energjisë dhe Infrastrukturës, si dhe zëvendësministrija e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Relatore e komisionit është zonja Evis Kushi...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pra, relator i projektligjit për energjinë është zoti Arben Pëllumbi, ndërkohë që zonja Kushi është relatore për projektligjin e dytë, i cili ka të bëjë me financimin e bizneseve të vogla dhe të mesme.

Do të fillojmë me prezantimin e projektligjit nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës dhe më pas me pyetjet.

Urdhëroni.

**Ilir Bejtja** – Për t’ju sqaruar, kjo nuk është një kredi që i është dhënë qeverisë shqiptare, por është në kuadrin e marrëveshjes financiare midis dy qeverive, ku bashkëpunimi financiar ka filluar në vitin 2010, ku nga ana e qeverisë gjermane mbuluesi i mbështetjes financiare është KfW-ja. Pra, pasi është bërë një studim i tregut lidhur me aftësinë për mjete financiare të tregut për të mbështetur iniciativat private, në vitin 2015 KfW-ja në kuadrin e kësaj marrëveshjeje financiare, ka propozuar të financojë me 12 milionë euro bankat e nivelit të dytë që të rrisin aftësinë e tyre likuiduese për ta mbështetur biznesin në projekte eficiente. Ka rezultuar se pjesa e likuiditetit nuk ka qenë problem, pasi bankat kishin mjaftueshëm fonde, e dyta, ishte pjesa e kolateralit.

Duke qenë se këto janë projekte që në përgjithësi zënë vlera të konsiderueshme këto biznese nuk kanë pasur mundësi të mbulojnë me kolaterale kërkesat apo projektet e tyre për eficiencë.

Pra, kjo është panorama. Ne si qeveri nuk e kemi marrë këtë kredi, por është një kredi që u është dhënë nga KfW-ja bankave të nivelit të dytë. Përfaqësuesit e KfW-së kanë gjykuar se kredia nuk është e lëvrueshme për ato kushte që sapo ju thashë dhe për këtë arsye kanë kërkuar të zgjedhin një sektor tjetër financimi po me të njëjtat para, pra të diversifikojnë, jo ta anulojnë si financim, por ta kalojnë nga sektori i eficiencës në bujqësi. Për këtë qëllim, duke denoncuar edhe kredinë tjetër përsëri për bankat, krijohet edhe fondi i garancisë për bizneset rurale, i cili do të shërbejë për të mbuluar pjesërisht kolaterale të cilat do të duhen për projektet në bujqësi.

Kemi apo nuk kemi nevojë, ne jemi duke marrë një kredi tjetër nga KfW-ja në mbështetje të një programi zhvillimi në sektorin e elektroenergjisë, i cili mund të shkojë deri në 140 milionë euro. Kjo po do të jetë një kredi, sepse mbulohet me garanci sovranë nga qeveria shqiptare dhe është në kuadrin e të njëjtit program që ne kemi filluar me Bankën Botërore. Projekti i eficiencës është i gjithi privat, qeveria shqiptare është nënshkruese e marrëveshjes financiare të 2010-ës dhe për këtë implikon edhe parlamentin në ratifikim, pra nuk është kredi e dhënë për qeverinë tonë, por është kredi për bankat e nivelit të dytë.

Kjo është e arsyeja e denoncimit, nuk është gjetur fusha e përdorimit, kështu që do të kalojë në bujqësi.

**Erion Braçe** – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit, kryetar!

Zëvendësministri na e sqaroi shumë qartë qëllimin e projektligjit që ka ardhur sot në Kuvend, prandaj e falënderoj për këtë.

Më lejoni shkurtimisht të përqendrohem në esencën e këtij projektligji. Kjo nuk është një kredi e marrë nga qeveria shqiptare, por është një kredi që qeveria gjermane në kuadrin e marrëveshjes që ka me qeverinë shqiptare për mbështetjen financiare i jep sektorit bankar për të ndihmuar me kredi ndërmarrjet e vogla në fushën e eficiencës energjetike.

Pra, duke qenë se këto projekte, siç e tha edhe zëvendësministri, janë projekte që kalojnë një nivel të caktuar, është parë se nuk ka qenë problem çështja e financimit të këtyre projekteve, por ka qenë problem çështjet e kolateralit, pasi ndërmarrjet e mesme dhe të vogla nuk e mbulonin dot me kolateral marrjen e këtyre kredive. Për këtë arsye, duke qenë se ligji nr. 89, i vitit 2015, i cili është ratifikuar në parlament, nuk lejon transferimin e këtyre fondeve për një projekt tjetër, është e detyrueshme të bëhet denoncimi i kësaj marrëveshjeje që të mund të lidhet një marrëveshje e re, e cila është trajtuar midis qeverisë shqiptare dhe qeverisë gjermane për të kaluar në fushën e bujqësisë dhe për të ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në këtë fushë.

Pra, për këto arsye dhe që të kryhet kjo gjë ne duhet të denoncojmë marrëveshjen e vitit 2015 që t'i japim mundësi lidhjes së një marrëveshjeje të re. Meqenëse ky projektligj vjen në parlament në përputhje me Kushtetutën, me procedurat dhe me Rregulloren e Kuvendit, i ftoj kolegët ta miratojmë atë.

**Erion Braçe** – Faleminderit!

A ka pyetje? Nuk ka.

Diskutime?

Po, zoti Hasa.

**Endri Hasa** – Thuhet që kjo marrëveshje, e cila është bërë që në vitin 2015, nuk qenka bërë efektive. Pse? Sepse bankat paskan tepërcë likuiditeti...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Më 2010, por në 2015-ën është ratifikuar dhe është bërë efektive, në datën 6 korrik 2015, zonja Kushi.

Më 6 korrik të vitit 2015 ka kaluar në parlament dhe është bërë efektive. Pra, ka 3 vjet që ju pranoni këtu se nuk është bërë asgjë. Ju thoni se fajin e kanë bankat që kanë shumë likuiditet, e ka sistemi e të tjera. A ia bëni vetes pyetjen: pse kanë bankat shumë likuiditet? A i bëni vetes pyetjen: si ka mundësi që këtu ndërtohen kulla pa fund dhe nuk kreditohen kullat, sepse praktikisht janë paratë e drogës, të cilat jua kemi përmendur, që investohen sot në ndërtim në të zezë dhe bankave u ngelen paratë aty se nuk kanë se si ta kreditojnë ndërtimin, siç duhej të ishte, pasi ka bum ndërtimesh dhe i kanë lekët e tepërta dhe në atë moment nuk kreditojnë as biznesin e vogël dhe as eficiencën e energjisë? Si ka mundësi që nuk investohet dot në energji? Atëherë, gabimet qëndrojnë në vend tjetër, pasi ministria nuk është marrë me këtë punë, sepse hallin qeveria e ka në vend tjetër. Nuk mund të vidhnin këtu ndonjë gjë, sepse banka ishte me privatën dhe ministria nuk mund t'i fuste dot duart, prandaj vendosët të bënit një marrëveshje tjetër që t'i fuste duart ministria. Ky është problemi për ju, tjetërsimi i truallit publik me ligj, ndërsa ju ofendoheni se unë po ju them që kjo është vjedhje? Vjedhje është, sepse si do ta quanit ju diçka që bëhet ligj me emër? Ligji "Fusha"!

Vjen këtu drejtori i hipotekës dhe fsheh se kush janë pronarët. Bleu Nastradini një gozhdë atje tek Teatri, aty afër zonës dhe tha: "Unë do të bëj propozim dhe do ta marr të gjithën". Po jepini ndonjë ide ose bëni një propozim që ta marrë edhe atë që ka përballë ai, sallën e Kuvendit, se nuk kemi se për çfarë ta duam. Ju ia dhatë votën, jepjani edhe për sallën, ta marrë të gjithë zonën dhe ta zhvillojë, të bëhet nami, se në këtë mënyrë do të rritet edhe ekonomia, sepse kështu u shpreh zoti Braçe, këtu në komision. Zoti Braçe ka thënë: Edhe ky zhvillim është, do të ndërtohet atje, ia falim njërit apo ia falim tjetrit...

**Erion Braçe** - Jo, zoti Braçe nuk ka thënë ashtu...

**Endri Hasa** – Ju e thatë...

**Erion Braçe** – Kur më citoni mua, ose më citoni ashtu siç unë shprehem, ose mos më citoni fare. E para, unë nuk kam thënë asgjë për këtë çështje dhe as nuk më ka interesuar...

**Endri Hasa** – Kjo sjell zhvillim, - keni thënë. Mund të shohim edhe procesverbalin.

**Erion Braçe** – Kush sjell zhvillim?

**Endri Hasa** – Ndërtimi sjell zhvillim, - u shprehët ju!

**Erion Braçe** – Kush ta ka thënë këtë?

**Endri Hasa** – Ju u shprehët më parë...

**Erion Braçe** – A e ke mendjen këtu, apo jo?

Vazhdo.

**Endri Hasa** – Zhvillim! Bëhet nami këtu, sjell zhvillim për xhepat e pushtetarëve, për atë oligarkun aty, për ato 200 milionë euro që po i fal. Pse po ia falni, është pronë e shqiptarëve, është pronë e publikut? Pse duhet t'ia falni? Pse duhet të vidhet?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po falet, kjo është vjedhje. Ka garë, në qoftë se nuk është falje, atëherë ka garë. Ky vend ka detyrime, ka ligje, ka garë. Këto gjëra nuk bëhen me ligje që i shpikni ju dhe votoni çdo lloj gjëje me votim Kuvendi dhe i jepni...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Çfarë po negociohet?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po, vjedhja. Sa shumë do të vidhet? Kontrata që ka gati Erion Veliaj?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po, këto nuk i dini ju, nuk keni si t'i dini...

**Erion Braçe** – Zoti Pëllumbi, të lutem, se jemi mbledhur për tjetër gjë!

**Endri Hasa** – Juve ju përdor Edi Rama thjesht si marioneta...

**Erion Braçe** – A do ta mbarosh diskutimin, zotëri?

**Endri Hasa** – Po, do ta mbaroj...

**Erion Braçe** – Jemi duke folur për një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Këshillit Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermani për marrëveshjen...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Më falni, për marrëveshjen mes Bashkisë së Tiranës për të cilido tjetri flasim herë tjetër! A keni ndonjë gjë për të thënë për këtë?

**Endri Hasa** – Po kam.

**Erion Braçe** – Urdhëro!

**Endri Hasa** – Të gjitha kanë lidhje me njëra-tjetrën.

**Erion Braçe** - Jo, nuk ka asnjë lloj lidhjeje kjo marrëveshje me...

**Endri Hasa** – Ka lidhje ...

**Erion Braçe** – Zero. Në qoftë se keni ndonjë gjë për këtë...

**Endri Hasa** – Ju jeni duke i hedhur poshtë këto, sepse ata kanë qenë të paaftë ta zhbllokojnë...

**Erion Braçe** – Të lutem, kur lexoni tamam...

**Endri Hasa** - ... eficiencën e energjisë...

**Erion Braçe** – Lexoje, se nuk të vret...

**Endri Hasa** – Zoti Braçe, uroj që të keni lexuar po aq sa edhe unë!

Kaq jam duke ju thënë, pavarësisht moshës...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Erion Braçe** – Të lutem shumë, të mbaroj zotëria...

**Endri Hasa** – Ju lutem shumë, mos flisni këtu për lexime, mos flisni këtu për epitete, jo po ka specialistë, jo nuk ka specialistë...

**Erion Braçe** – Fjala juaj mbaron këtu.

Fjalën e ka zoti Spaho.

**Endri Hasa** – Ne kemi specialistë...

**Erion Braçe** – Zoti Spaho, e keni ju fjalën.

**Endri Hasa** – Unë nuk kam mbaruar, nuk keni pse të ma hiqni fjalën...

**Erion Braçe** – Nuk jeni duke folur për çështjen që kemi në rendin e ditës...

**Endri Hasa** – Më lini ta mbaroj fjalën...

**Erion Braçe** – Zoti Spaho, e doni fjalën?

**Edmond Spaho** – Patjetër që e dua fjalën, po këtu nuk jemi në repart ushtarak. Kolegu nuk e ka mbaruar ende fjalën, ndërsa ju kërkonit të përcaktoni...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Erion Braçe** – Zoti Spaho, ju para 10 minutash folët për Rregulloren, për zbatimin e Rregullores e të tjera me radhë...

**Edmond Spaho** – Nuk mund ta përcaktoni ju linjën e diskutimit...

**Erion Braçe** – Unë jam duke zbatuar Rregulloren pikë për pikë...

**Endri Hasa** – Je duke zbatuar Rregulloren, duke më hequr fjalën?

**Erion Braçe** – Zotëria nuk po flet fare për thelbin e çështjes, nuk është anëtar i këtij komisioni, por vjen këtu...

**Endri Hasa** – Jam duke folur për paaftësinë e qeverisë për marrëveshjen...

**Erion Braçe** - ... dhe na harxhon kohën kot...

**Endri Hasa** - Jo, nuk po jua harxhoj kohën...

**Erion Braçe** - ... në qoftë se e doni fjalën zoti Spaho, në rregull, në të kundërt do të kaloj në votim dhe të ecim përpara.

Fjala për zotin Spaho.

**Endri Hasa** – Zoti Braçe, a ta mbaroj fjalën?

**Erion Braçe** – Shko në komisionin tënd dhe fol atje sa të duash, këtu jo.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Unë do të të gjej punë ty për njerëzit? Nuk më intereson fare...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Endri Hasa** – Unë do ta mbaroj fjalën...

**Erion Braçe** – Zoti Spaho...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Kalojmë në votim në parim të...

**Endri Hasa** - Pse i trembesh fjalës kaq shumë...

**Erion Braçe** - ... projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 89/2015...

**Edmond Spaho** – Zoti Braçe, më keni dhënë fjalën... .

**Erion Braçe** – Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

**Endri Hasa** – Zoti Spaho, po pret të marrë fjalën...

**Erion Braçe** – Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim projektligjin në tërësi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

**Endri Hasa** – Ku e keni gjetur këtë dordolec? A ka mundësi ta marrim fjalën? Jepja fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotëri!



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Ekonominë dhe Financat***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 17.07.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Erion Braçe – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

2. Projektligji “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015.

**Marrin pjesë:**

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Evis Kushi, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Edmond Spaho, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto, Përparim Spahiu dhe deputetë të tjerë të Partisë Demokratike.

**Mungojnë:**

Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Agron Shehaj, Dashamir Shehi, Fatbardha Kadiu dhe Reme Lala.

**Të ftuar:**

Dorina Çinari- Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja - Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi – drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Albana Shkurta - zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi – drejtore në Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – specialist në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

**Erion Braçe** – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015””.

Zonja zëvendësministre, e keni ju fjalën!

Më falni, për procedurë e ka fjalën zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Zoti Braçe, para se ta marr fjalën duhet të vendosësh rregull dhe qetësi, sepse nuk mund të flas mbi zërin e të tjerëve.

Në fakt, aq sa dëgjuam nga përfaqësuesi i qeverisë për marrëveshjen që ju sapo votuat, për të cilën do të dëgjojmë edhe nga grupi tjetër që do të flasë për pikën e fundit, në thelb, ju po anuloni dy marrëveshje që janë pjesë e programit të bashkëpunimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale Gjermane, program i vitit 2010. Të dyja këto marrëveshje janë ratifikuar nga ju në vitin 2015.

Pra, keni pasur kohë t’i studioni, t’i shqyrtoni projektet që janë propozuar, të cilat janë propozuar nga pala shqiptare si fusha e parë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ashtu edhe fusha e dytë për eficiencën e energjisë. Pavarësisht se kredia i jepet sistemit bankar, programi është qeveritar, fushat janë zgjedhur nga qeveria shqiptare në bashkëpunimin me qeverinë e Republikës Federale Gjermane.

Pra, njëra është 5 milionë, ndërsa tjetrën e kam të paqartë se sa është, pasi nuk jepet shifra e saktë, thelbi është që këto para që duhej të ishin përdorur për këto fusha nuk janë përdorur dhe sot propozohet të përdoren për disa fusha të tjera, pasi kanë kaluar 3 vjet. Nuk ka justifikim të thuash sot që, kur e hartuam marrëveshjen, menduam që nevojat ishin në financim, në linjën e kredisë, kurse pas 3 vjetësh kuptojmë se nuk kanë qenë në ligjin e kredisë, por kanë qenë në linjën e garantimit të kolateralit. Ku ishit ju...?

**Erion Braçe** – Zoti Bushaj, ju lutem, mos ndërhyini!

**Edmond Spaho** - ... në 2015-ën kur kërkuat linjë krediti dhe nuk kërkuat garantimin e kolateralit? Pse u dashka të ikin 3 vjet për të kuptuar se në këtë sektor problemi qenka garantimi i kolateralit dhe jo linja e kreditit? Nuk është problem t’i marrësh vesh këto fundamente të sektorit. Kjo është puna e dobët e atyre që janë marrë me këtë çështje dhe që kanë propozuar të futet te kjo fushë. Për 3 vjet kemi rrahur ujin në havan. Këtë çështje e ngre edhe si shqetësim për marrëveshjet e tjera që miratojmë, sepse nuk ka garanci që nesër ju nuk do të vini prapë me këtë logjikë dhe do të thoni që nuk janë vetëm këto 2 marrëveshje që kemi anuluar këtu, por ka edhe disa marrëveshje të tjera që i kemi anuluar, por kanë kaluar në

këtë mënyrë se ne nuk kemi qenë të pranishëm në komision, kjo është praktikë me këtë qeveri dhe është shumë shqetësuese.

Në radhë të parë, duhet ta ngrini ju zërin se jeni maxhorancë dhe jeni në qeverisje për të garantuar efektivitet të fondeve të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Mos na thoni çudira! Vjen përfaqësuesi i qeverisë dhe shprehet se nuk e merr qeveria! Po kush e merr? Në çdo rast programi është qeveritar dhe nevojat janë përcaktuar në bashkëpunim me qeverinë. Në fund përdoruesi, sigurisht, po të jetë pushteti vendor, le ta marrë pushteti vendor, po ishte sistemi bankar, le ta marrë sistemi bankar, po të jetë një linjë tjetër, le ta marrë ai institucion, por kjo është pjesë e programit qeveritar, është përgjegjëse qeveria për atë që ka hedhur në letër, sepse e kanë nënshkruar dy qeveritë, ajo shqiptare dhe gjermane.

**Erion Braçe** – Po, zonja Kushi.

**Evis Kushi** - Faleminderit, kryetar!

Më vjen keq që një pjesë e mirë e debatit për këtë çështje u konsumua ende pa u prezantuar projektligji, në mungesë të detajeve specifike, të cilat ishin të rëndësishme të theksoheshin para se të zhvillohej debati, megjithatë, në respekt të Rregullores, edhe të medieve që janë të pranishme, në mënyrë të përmbledhur do t'ju theksoj se bëhet fjalë për një projektligj, i cili në thelb denoncon një marrëveshje, e cila është lidhur në vitin 2015, midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë me qëllim financimin e një projekti për të financuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, faza e dytë, e një projekti dhe i një programi që është hartuar vite më parë, pra që në vitin 2010.

Marrëveshja parashikonte konkretisht financimin nga Banka Gjermane KfW të një huaje me kushte të favorshme prej 10 milionë eurosh. Në fakt, ligji nuk u zbatua jo sepse bankat e nivelit të dytë nuk kishin likuiditet, pra nuk kishin mjete financiare, por për shkak se mungonte garancia e huamarrësve për kthimin e kredive. Prandaj, me propozimin e bankave të nivelit të dytë palët ranë dakord që të përdorej një instrument tjetër po në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ja, sa ta mbaroj fjalën!

Është një program, i cili ka filluar që në vitin 2010, ka qenë faza e dytë. Konkretisht, palët kanë rënë dakord që projekti i ri të realizojë një mbështetje nëpërmjet fondit të garancive rurale, duke marrë një shumë financiare prej 5 milionë eurosh. Unë i propozoj komisionit ta votojmë këtë projektligj, por, meqenëse edhe kolegët...

*(Diskutime pa mikrofon)*

... e opozitës kanë shqetësim, kam dy pyetje për zëvendësministren, sepse mendoj se të gjithë kolegët kanë nevojë për më shumë informacion.

Pra, nga njëra anë kemi mosrealizimin e marrëveshjes të vitit 2015, e cila çoi në mospërfitimin e kredisë prej 10 milionë eurosh dhe nga ana tjetër projekti i ri që propozohet do të jetë me një financim 5 milionë euro, para që do të merren nga mjetet e KfW-së, që ia ka premtuar qeverisë shqiptare për projekte të tjera, por që nuk janë zbatuar. Kam dy pyetje.

Pyetja e parë: A ka pasur një analizë apo një studim përpara se të nënshkruhej marrëveshja në vitin 2015 midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë”. Pra, a ishte e mundur të parashikohej që ky projekt nuk do të mund të zbatohet?

Së dyti, cilat janë arsyet e mosrealizimit të projekteve të tjera, pra të këtyre 5 milionë eurove, që shkojnë nga disa projekte të tjera, që vijnë për të financuar SME-të?

**Erion Braçe** – Fjala për zonjën ...

**Albana Shkurta** – Faleminderit!

Për sa u përket sqarimeve që dha zonja Kushi në lidhje me denoncimin e kësaj marrëveshjeje, do të thosha se më tepër se një marrëveshje, apo ligj që nuk është zbatuar, është formatim i një forme ndihme të dhënë nga qeveria gjermane në një instrument që tani u përshtatet kushteve më mirë sesa në kohën kur është konceptuar kjo kontratë si një instrument ndihme.

Sigurisht, po të ishte bërë studimi i parafizibilitetit nga ana e KfW-së apo qeverisë gjermane në kuadër të mbështetjes që ofronin, do të ishte evituar deri diku lloji i formatimit të kësaj forme mbështetjeje për SME-të, por ndërkohë, duke pasur parasysh periudhën nga viti 2010 deri në vitin 2015, kushtet e konceptimit të formës mbështetëse kanë ndryshuar gjatë kësaj kohe.

Të mos harrojmë edhe kontekstin e sistemit bankar, presionin e jashtëzakonshëm që ka pasur, për sa i përket eliminimit të kredive të këqija, gjë që e shtyn të prezantojë kritere të tjera strikte për dhënien e kredive, veçanërisht për ato lloj ndërmarrjesh që, siç e dimë të gjithë, gjithmonë kanë vështirësi për sa i përket mënyrës së gjetjes së formave të financimit duke pasur parasysh mungesën e kolateralit, në veçanti ato ndërmarrje, të cilat operojnë në zonat urbane apo rurale.

Ndërkohë, pasi fondet u bënë aktive për sistemin bankar, pas kryerjes së kësaj analize, pas intervistave të shumta, të gjitha rastet e aplikimeve për kredi u rrëzuan, ose nuk u pranuan nga sistemi bankar për shkak se aplikuesit nuk i plotësonin kushtet me kolateral. Këto fonde, të cilat ishin menduar për t’iu ofruar likuiditet bankave të nivelit të dytë, në fakt, do të ishin shumë më të përdorshme në rast se do të zbusnin pikërisht këtë risk, që

bankat e nivelit të dytë të mos e merrnin vetë, por kjo të futej si një instrument ndihme dhe mbështetjeje, qoftë për bankat, që të mos përballojnë të gjithë riskun, ashtu edhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat në aplikimet që bëjnë për të përfituar mbështetje nga kjo skemë, në një farë mënyre të kenë barrën e sigurimit të kolateralit. Ky është i gjithë thelbi i marrëveshjes, apo i ndryshimit dhe riformatimit të një forme ndihme. Unë kështu do ta quaja, megjithatë, termi ligjor është “denoncim”, por është i ngjyruar me pjesën që u jep dritë gjithë komenteve, duket sikur në vetvete është diçka negative.

Kushtet e sistemit bankar janë të tilla që ne nuk i ndihmojmë dot duke u shtuar likuiditetin, të cilin e kanë, por duke ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që të rrisin kapacitetin për të pasur akses në kredi dhe në financim.

**Erion Braçe** – Faleminderit!

Fjala për zotin Spaho.

**Edmond Spaho** – Nga shpjegimi që dha zonja zëvendësministre, kuptova që faji është i KfW-së dhe i qeverisë gjermane. Ju thatë se KfW-ja duhet të kishte bërë studim fizibiliteti në atë kohë, e thatë kështu, apo jo, në vitin 2015, që të përcaktonte më mirë nevojat. Keni thënë ekzaktësisht këtë, po të doni shikojmë rekordet! I bie që fajin e ka qeveria gjermane dhe institucioni financiar gjerman, të cilët na paskan imponuar një projekt për të cilin nuk kemi pasur nevojë! Këtë thatë!

Nga shpjegimet e tjera kuptova që biznesi privat shqiptar ka aplikuar për kredi, domethënë paska pasur nevojë për të marrë kredi, por më pas ka rezultuar që nuk kanë pasur as garanci. Pra, biznesi ka nevojë edhe për mjete financiare për kredinë, por edhe për kolateral. Këtë thatë!

Pra, cili është thelbi i gjithë debatit që po bëjmë? Puna që është bërë në periudhën 2013-2014-2015, është bërë shkel e shko. Sot në vitin 2018, marrëveshjen që miratuam si parlament në vitin 2015, po e hedhim poshtë dhe nuk kemi kurajën të themi: - “Po, gabuam!”, sepse, duke pasur kurajë dhe duke e pranuar gabimin, do të kemi mundësi të mos gabojmë në të ardhmen. Ju nuk e keni këtë kurajë, por vini e përdridheni këtu me lloj-lloj shpjegimesh – “Në atë kohë nuk kishim nevojë për këtë, por mbas tre vjetësh e kuptuam që nuk kemi nevojë për këtë. Kemi nevojë për atë dhe tani po ndryshojmë marrëveshjen” – Pikërisht për këtë ju qortojmë, që nuk keni bërë punën dhe nuk është hera e parë! Sektori juaj nuk është i vetmi që anulon marrëveshje të nënshkruara të disa viteve më parë.

Ja ku janë gazetarët, le të shikojnë kalendarin e punimeve të Kuvendit, të shfletojnë marrëveshjet e 6-muajve të fundit dhe do të gjejnë raste të tjera të denoncimit të anulimit të marrëveshjeve të tjera.

Indicioja është marrë nga termi “Denoncim”. Kjo gjë nuk është normale, për të mos thënë ndonjë fjalë tjetër!

**Erion Braçe** – Do të doja të bëja vetëm një korrektim: besoj se zonja që është këtu nuk ka ndonjë përgjegjësi personale, sepse ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...dakord, por u duk sikur...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Spaho, ndonjëherë kur diskutohet, edhe mund të keqkuptohet. Zonja në fjalë nuk ka përgjegjësi për këtë!

Fjala për zotin Balliu.

**Klevis Balliu** – Çështja nuk është vetëm te marrëveshja, por te praktikat e qeverisë. Për të mos përsëritur edhe kolegët e imi, janë një seri marrëveshjesh, të cilat nuk qëndrojnë. Kërkohen para kur nuk duhet, nuk bëhet puna kur vijnë. Praktikrat e qeverisë janë problemi thelbësor, jo marrëveshjet; respektimi i ligjit, është problemi, jo vetë ligji.

Ndaj, shpesh vijmë këtu e përplasemi për gjëra që vërtet mbase nuk janë në rendin e ditës, por janë gjëra që na shqetësojnë, si vjedhja e një prone publike, e cila i jepet një privati. E majta në tërësi, në të gjithë botën, nuk mund ta konceptojë që të marrë pronën publike, thjesht, edhe nga ana ideologjike e saj, dhe t’ia japë privatit, apo si doni ta quajmë, pronarit të kompanisë “Fusha” si koncesionar.

Dje dëgjova me vëmendje drejtorin e Hipotekës, i cili, kur përmendej zoti Fusha thoshte: - “Nuk ka rëndësi!” – Si nuk paska rëndësi?! Ky njeri po merr një pronë publike thjesht se ka në pronësi rreth 100 e ca metra katrorë, për këtë po i jepen edhe gati 8000 metra katrorë, se nuk po e marrim vesh sa metra janë aty, dhe ky thotë - nuk ka rëndësi. Ndërkohë, “Fusha” do të bëhet pronari i kullës, pronari i Teatrit, se ky do ta ndërtojë, për të mos i hyrë pjesës tjetër të vlerave historike që ka Teatri e një serie gjërash.

Pse ndodhin këto? Ndodhin, sepse sot qytetarët po drejtohen nga një qeveri private, jo nga qeveria e shqiptarëve. Kjo është qeveri private e Edi Ramës! Kjo është ndërmarrje! Kryetar i ndërmarrjes, president, ministër Bujqësie, ministër Integrimi, ministër i Jashtëm e ç’të doni ju, është Edi Rama!

Problemi qëndron se kur vijmë këtu dhe përplasemi, nuk na dalin përballë ata që i bëjnë këto afera korruptive. Përplasemi me zotërinjtë që ndoshta nuk kanë lidhje me çështjen, pasi deputetët e tjerë që nuk kanë qenë të përfshirë, nuk e dinë se çfarë ka ngatërruar Fatmir Xhafaj me Agronin, apo se çfarë ngatërronte Saimiri me Balilin. Jo të gjithë mund të jenë të përfshirë, për këtë jemi të ndërgjegjshëm. Duhet ndarë shapi nga sheqeri.

Më parë u diskutua çështja e ndihmës ekonomike. Unë jam deputet në Pogradec dhe kam 5700 familje të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike. Pogradeci ka gjithsej 90 e ca mijë banorë....

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk i mbaj unë, zotëri, i mban shteti!

Ty duhet të të bëjë përshtypje që një vend me 90 mijë banorë ose afro 10000 banorë, paska 5700 familje që marrin ndihmë ekonomike. Gati 10% e popullatës së Pogradecit marrin ndihmë ekonomike. Kjo duhet të të bëjë përshtypje dhe jo lojërat e fjalëve! Por jeni të verbuar që duhet mbrojtur ndërmarrja apo qeveria private, se vetëm qeveria shqiptare nuk është, pasi nuk ka ardhur në pushtet me votat e tyre, por me lekët e Saimirit!

Normal, bëhen marrëveshje që fillojnë e nuk mbarohen, premtohet shëndetësia falas, e ku është sot falas shëndetësia, nuk e dimë! Pra, problemi ynë është praktika. Nëse doni të bëni një ndryshim, ndryshoni praktikën e qeverisë.

Thjesht sepse ai ka thënë: “Të bëhet kjo tani” - ne nuk u dashka të pyesim fare se kush është “Fusha” dhe nga na doli! Këtu e keni pasur raportin KLSH-së ku thuhej: “Kompania “Fusha” i ka bërë 300 e ca milionë lekë dëm buxhetit të shtetit në vitin 2017”. Atëherë, pse duhet ta marrë pikërisht kjo kompani dhe jo dikush tjetër? Pse nuk mund ta marrë tenderin një biznesmen më i aftë? Unë nuk e di as çfarë standardi dhe as çfarë niveli është kjo kompani, e cila para disa vitesh mezi merrte një tender në 5 vjet, ndërsa sot ka marrë 129 tendera. Kur u bë kaq e mirë kjo kompani?!

Pse nuk e shpronësoni Teatrin siç bëtë me Xhaminë, të hapet konkurrimi dhe të marrin pjesë edhe kompani të tjera? Si ky rast ka qenë edhe çështja e shëndetësisë me “Kecap”- in e Beqajt. As aty nuk u mor vesh gjë, edhe pse u bë gjithë ajo zhurmë.

Praktika është problemi, problemin e keni te lidërshipi juaj, i cili nuk di të funksionojë ndryshe, as të punojë ndryshe. Kur themi hajdutë, nuk është ofendim. Ofendim quhet kur ia thua një njeriu të drejtë - “Ti je hajdut!” - ndërkohë që nuk ka lidhje, por t’i thuash Edi Ramës, t’i thuash hajdutit - “hajdut” nuk është ofendim, por është fakt. Nuk ka shqiptarë, të majtë apo të djathtë, madje edhe i majti më ekstremist i Edi Ramës, thoshte: “Ka vjedhur, por ka bërë parkun “Rinia””, që as atë nuk e bëri vet. Këtij po që i themi hajdut ne! Në qoftë se e mbështesni, atëherë faji juaj është, sepse ky pa ju është një hiç. Çfarë është ky pa Partinë Socialiste? Do të ishte thjesht një bandit më shumë në krimin e organizuar. Fusin të vëllain në futboll, po i vëllai merret me bërjen e kullës te stadiumi, po ashtu, i vëllai del te çështja e “Xibrakës”. Asnjë fjalë s’u tha nga ju për vëllain e tij. Qindra njerëz hiqen nga ndihma ekonomike, prapë asnjë fjalë; del përgjimi i avionit, prapë asnjë fjalë; del përgjimi i Balilit, i

Saimirit, asnjë fjalë përsëri. Shpikje janë të gjitha këto?! Ju i paskeni ditur të gjitha?! Ju qenkeni më të mirët?! 27 vjet këtu...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju jeni më të mirët?! Po ju nuk keni bërë një rrugë në 5 vjet, more zotëri!

Keni 5 vjet që thoni se fajin e ka opozita që nuk u hapën negociatat. Turp i madh kush e dëgjon këtë!

Jam dakord që duhet respektuar Rregullorja dhe duhet të flasim për rendin e ditës, po ç'të flasësh për rendin e ditës kur shqiptarët po vdesin për bukë! Këtu duhet të diskutojmë se çfarë po bëhet me çmimet. Ç'po bëhet me çmimet e apartamenteve në Tiranë? 4500 euro metri katror është vlera te pallati që do të ndërtojë "Fusha". Ku jetojmë, o zotëri, në San Trope? 400 mijë lekë rroga mesatare, ju do ta bëni 4000 euro metrin katror? Dhe qenkeni ju më të mirët?! Kur qenkeni më të mirët, si është e mundur që gjatë qeverisjes suaj u kanabizua i gjithë vendi? Kur jeni më të mirët, si ka mundësi që Saimir Tahiri, se ne ministrat tanë të Brendshëm ende i kemi në parlament, një herë futet në arrest shtëpie, një herë futet në burg e herë tjetër del nga burgu?

Akuzat që keni ndaj Partisë Demokratike, shumë mirë që i keni! Paskan bërë vrasje, krime, arrestojini, pra! Shumë mirë që e bëtë vetingun, morët sistemin e drejtësisë dhe ta gëzoni, por pse nuk i arrestoni? Bëni vetëm akuza...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju keni bërë akuza të rënda. Mua më keni thënë vrasës, kriminel, ke bërë këtë, ke bërë atë, ke vjedhur...! Më arrestoni, mor zotërinj! Ku është Ministria e Brendshme kur unë paskam vjedhur, qenkam kriminel, paskam bërë vrasje? Pse qëndrojmë ende këtu? Ku është qeveria?! Atëherë jep dorëheqjen, largohu nëse nuk je i zoti!

E keni kthyer në absurditet, e keni kthyer Shqipërinë në një shtet të dyfishtë ku nuk ka Gjykatë Kushtetuese e që nuk është shteti i shqiptarëve, në një shtet ku nuk ka Gjykatë të Lartë, në një shtet ku prona publike i jepet me ligj një koncesionari që deri dje nuk e njihje askush! Thirrini mendjes, se nesër, pasnesër do t'ju duhet të jepni përgjigje për këto çështje, se nuk janë kaq të thjeshta!

Sot e keni në dorë pushtetin, ministrat, po jua quajmë se i keni edhe votat, pavarësisht se i bletë ato me lekët e Saimirit dhe Moisiut, por nesër, pasnesër, do t'ju duhet të flisni me njerëzit e të përballeni me ta. Do t'ju thonë: "Ku është ekonomia sot? Pse janë shtuar njerëzit që marrin ndihmë ekonomike?". Ju thoni se ka abuzime në ndihmën ekonomike, por atë proces po e drejtoni ju prej 5 vjetësh. A janë bërë këto abuzime në kohën tuaj? Dakord, ejani

t'i rregullojmë, ejani të merremi me to, por jo nga ekstremi në ekstrem, o zotërinj, se po na vdesin njerëzit rrugëve!

Cili nga ju foli për dy të rinjtë që vdiqën në Laç se po kërkonin skrap? Këto gjëra po ndodhin ende në vitin 2018 te ne dhe ne flasim për t'u bërë pjesë e Europës. Secilit duhet t'i vijë turp vetëm që ta mendojë atë!

Del ky te ERTV-ja dhe na thotë: “Është shumë bukur, ka rritje turizmi...”, prandaj na janë shtuar edhe eurot neve këtu, ndërkohë që euro ka që në shtator që po rritet. Jemi kthyer në shtet absurd, o zotërinj, se po drejtohem nga njerëz absurdë, që nuk kanë një program ekonomik. Erdhi në pushtet e thoshte: “Tepsia, tenxherja”, asnjëri nuk e mori vesh, thjesht se i kishte votat e garantuara. 74 vota donte, për 74 pagoi dhe 74 vota mori.

Po të doni vazhdojeni, në dorë e keni! Keni dy opsione, ose të vazhdoni në këtë linjë që jeni, dhe në qoftë se vazhdoni, e gëzofshi dhe ju shkoftë mbarë, ose në të kundërt bëni kthesë e jepuni përgjigje njerëzve se ku qëndron problemi, që të mos na dalin më as marrëveshje, të mos na dalë nga “Fusha” në “Çuli”, “Puçi”, cilët do nxirrni tjetër nga këta biznesmenët e rinj të vitit 2018, që vijnë nga hiçi dhe na dalin miliardë që mund të bëjnë 6 kulla. Marrin Teatrin, caktojnë edhe çmimin e biletës 300 euro për shfaqje, të cilat pastaj mund t'i shohin vetëm Edi Rama me Olsin.

**Erion Braçe** – Meqë nuk ka më diskutime dhe duhet të kalojmë në votim, dua të them dy-tri gjëra: së pari e mbi të gjitha, nga ai ligji “Fusha” siç thoni ju, me sa kam lexuar unë, Teatri i ndërtuar flas, mbetet pronë publike nën administrimin e Ministrisë së Kulturës nga fillimi...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Edhe një herë po ua përsëris, Teatri Kombëtar mbetet pronë publike nën administrimin e Ministrisë së Kulturës dhe jo nga ai që e ndërton.

Së dyti, koncesioni i kontrollit shëndetësor quhet “Check up” dhe jo “Kecap”...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ah, e kishit me ironi! Në rregull!

Së treti, ndihma ekonomike ndahet nga...

**Klevis Balliu** – Edhe ti e di që ishte “Kecap”, edhe ti e ke thënë kështu! Qëndroi fjalës tënde!

**Erion Braçe** - Unë e kam thënë qartësisht, në qoftë se më ke dëgjuar, që për shkakun tuaj, nuk mund t'i mohohet cilitdo të kryejë kontrollin bazë shëndetësor për shkak të ngjyrës, gjendjes ekonomike apo edhe mundësisë financiare. Kaq, mbaron këtu!

Me 80 mijë lekë është mohim i drejtpërdrejtë i këtyre, kontratën vetëm ju e keni. KLSH-ja ka bërë një raport kontrolli për këtë koncesion, referojuni, lexojeni meqë i referoheni shpesh KLSH-së për këtë.

Së treti, ndihma ekonomike ndahet nga bashkitë dhe jo nga qeveria. Në qoftë se ka abuzime, trokisni drejtpërdrejt në bashki.

Së katërti,...

**Klevis Balliu** – Jo, është dezinformacion i qëllimshëm! Edhe kolegët po qeshin!

**Erion Braçe** – Patjetër!

**Klevis Balliu** – Ne kemi bërë luftë në parlament, zoti Braçe, për sistemin e pikëzimit që keni bërë ju.

**Erion Braçe** – Patjetër që do të jetë me sistem pikëzimi, se ai që del atje me benz dhe me traktor, nuk mund të marrë edhe ndihmë ekonomike.

**Klevis Balliu** – Zoti Braçe, në qoftë se ka pasur abuzime, në këto 5 vjet keni qeverisur ju...

**Erion Braçe** - Ka pasur që ç'ke me të, se kanë shkuar në prokurori pjesa më e madhe...

**Klevis Balliu** – Ejani t'ju ndihmojmë ta zgjidhim, se abuzime ka pasur dhe do të ketë!

**Erion Braçe** - Së katërti, pa as më të voglin diskutim, unë nuk kam asnjë ndjesi të diskutoj për biznesmenët, me thënë të drejtën, e dinë të gjithë! Kompania “Fusha” ka ndërtuar treçerekun e Farkës. Ndërkohë, ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Klevis Balliu** – Ka marrë 4 tendera gjithsej deri në vitin 2013.

**Erion Braçe** -Po, pra.

Ndërkohë, kjo kompani ka qenë një nga operatorët kyç me kontrata të lidhura prej 4 vjetësh në Bashkinë e Tiranës...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

...ndërkohë që në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, kaq janë po prapë operatorë kyç.

**Klevis Balliu** – Zoti Braçe, edhe ju, edhe unë, po ta kishim marrë Farkën, nuk e ndryshon faktin që këtu po shkelet ligji, po vidhet toka. Nuk ka rëndësi kush e merr.

**Erion Braçe** - Çojeni çështjen në prokurori!

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i

ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr. 86/2015 .

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit!

Mirupafshim!

## **MBYLLET MBLEDHJA**